

URDHER
Nr. 174, datë 4.5.2020

**PËR MIRATIMIN E TE DHENAVE TEKNIKE TË DOSJES SË REGJISTRIMIT TË
PMB-ve**

N ë mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, si dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Bledar Çuçi

SHTOJCË

TË DHËNAT TEKNIKE TË DOSJES SË REGJISTRIMIT TË PMB-ve

PJESA A

PMB ME PËRMBAJTJE LËNDË VEPRUESE ME NATYRË KIMIKE

SEKSIONI 1
IDENTITETI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Kreu 1
Të dhëna të përgjithshme

Informacioni i siguruar, duhet të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar me saktësi PMB-të dhe të bëjë përcaktimin e tyre sipas specifikave dhe natyrës për secilën lëndë vepruese.

1.1 Aplikuesi

Emri dhe adresa e aplikuesit duhet të deklarohet së bashku me emrin, pozicionin, numrin e telefonit dhe të faksit, të personit të kontaktit.

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

1.2. Prodhuesi i PMB-së dhe i lëndës vepruese

Nëse lënda vepruese ka origjinë nga një prodhues, nga i cili të dhënat për lëndën vepruese nuk janë dorëzuar më parë, të dhënat për adresimin e këtyre kërkesave do të sigurohen për të vendosur ekuivalencën e lëndës vepruese.

1.2.1.Prodhuesi i PMB-së:

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

(Informacion konfidencial sipas përcaktimit të dhënë në kreun 2 të këtij seksioni)

1.2.2.Prodhuesi i lëndës vepruese

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

(Informacion konfidencial sipas përcaktimit të dhënë në kreun 2 të këtij seksioni)

1.2.3. Deklarata e pastërtisë (dhe informacioni i hollësishëm mbi papastërtitë) të lëndës/ve vepruese

Shtoni informacione mbi pastërtinë minimale të lëndës/ve vepruese;

Raportet e ekuivalencës: në rastin kur ka pasur një ndryshim në vendin e prodhimit ose specifikimin e lëndës/ve vepruese, atëherë duhet të bëhet referencë në raportin e ekuivalencës;

Kur ka informacion në lidhje me papastërtitë, ky është informacion konfidencial i cili jepet sipas përcaktimit të dhënë në kreun 2 të këtij seksioni.

1.3. Emri tregtar ose propozimi për emrin tregtar, si dhe numri i kodit i vendosur nga prodhuesi për PMB-në, kur është e nevojshme.

Duhet të deklarohen të gjithë emrat tregtarë të mëparshëm dhe të tanishëm, si dhe emrat tregtarë të propozuar dhe kodet e PMB-ve të dhëna nga prodhuesi. Kur emrat tregtarë dhe numrat e kodeve kanë të bëjnë me PMB të ngjashëm (që mund të jenë të pa rëndësishëm), duhet të jepet informacion i detajuar mbi ndryshimet midis këtyre PMB-ve. Emri tregtar i propozuar nuk duhet të jetë shkak për konfuzion me emrin tregtar të një PMB-je të regjistruar. Çdo numër kodi do të jetë specifik për një PMB unike.

1.4. Informacion i detajuar sasior dhe cilësor mbi përbërjen e PMB-së (Informacion konfidencial i cili jepet sipas përcaktimit të bërë në kreun 2 të këtij seksioni)

1.4.1. Përbërja e produktit për mbrojtjen e bimëve (Përmbajtja e lëndës/ve vepruese dhe formuluesve).

Për PMB-të duhet të jepet informacioni i mëposhtëm:

- përmbajtja e lëndëve vepruese teknike si dhe e lëndëve vepruese të pastra;
- përmbajtja e mbrojtësve, synergistëve dhe bashkë-formuluesëve;
- përmbajtja maksimale e papastërtive përkatëse, kur është e përshtatshme.

Përveç përmbajtjes totale të lëndëve vepruese, për PMB-të me lëshim të ngadaltë ose të kontrolluar (të tilla si kapsula në pezulli-CS) do të jepet përmbajtja e lëndëve vepruese jo të kapsuluara dhe të kapsuluara, si dhe shkalla e lëshimit. Kur është e mundur, do të përdoren metodat

e duhura të Këshillit Analitik të Pesticideve Bashkëpunuese Ndërkombëtare (CIPAC). Nëse përdoret një metodë alternative, kjo do të justifikohet nga aplikanti dhe do të jepet një përshkrim i hollësishëm i metodologjisë së përdorur.

Përqendrimi i secilës lëndë vepruese shprehet si më poshtë:

- për materialet e ngurta, aerosolet, lëngjet e paqëndrueshme (pika maksimale e vlimit 50 °C) ose lëngjet viskoze (kufiri i poshtëm 1 Pas në 20 °C), në % ë/ë dhe g/kg;
- për lëngje të tjera/formulime xhel, në % ë/ë dhe g/lit;
- për gazrat, në % v/v dhe % ë/ë.

1.4.2. Informacion për lëndët vepruese.

Për lëndët vepruese duhet të jepen emri i zakonshëm ISO ose emri i propozuar ISO si dhe numrat CIPAC, dhe, kur ekziston, numri EEC (EINECS ose ELINCS). Kur është e nevojshme, duhet të deklarohet se cila kripë, ester, anion ose kation ndodhet në lëndën vepruese.

1.4.3. Informacion për përbërësit e formulës (mbrojtësit, synergistët dhe bashkë-formuluesit).

Mbrojtësit, synergistët dhe bashkë-formuluesit, kur është e mundur, duhet të identifikohen nga emri kimik, ose, kur nuk është e mundur, të identifikohen sipas nomenklaturave IUPAC dhe CA. Duhet gjithashtu të jepet struktura ose formula e strukturës së tyre. Për të gjithë përbërësit e formulës, duhet të jepen, kur ekzistojnë, numrat përkatës EEC (EINECS ose ELINCS) dhe numrat CAS. Kur informacioni i dhënë nuk mjafton për të identifikuar përbërësit e formulës, duhet të sigurohet një specifikim i përshtatshëm. Duhet gjithashtu të jepet, kur ekziston, emri tregtar i përbërësve të formulës.

1.4.4. Për bashkë-formuluesit duhet të jepet funksioni i tyre:

- adegjiv;
- lëndë anti shkumëzuese;
- anti ngrirës;
- lidhës;
- zbutës;
- mbartës;
- deodorant;
- lëndë shpërndarëse;
- ngjyruar;
- emetin;
- përzierës;
- fertilizant;
- ruajtës;
- aromatik;
- parfum;
- lëvizës;
- zbrapsës;
- element sigurie;
- tretës;
- stabilizues;
- sinergjik;
- trashës;
- lëndë njomëse;
- të ndryshme (të specifikohet).

1.4.5. Procesi i formulimit

1.4.5.1. Përshkrimi i procesit të formulimit

Në këtë rubrikë jepet përshkrimi i procesit të formulimit.

1.4.5.2. Diskutimi mbi formimin e papastërtive të shqetësimit toksikologjik

Në këtë paragraf jepet informacion për çdo papastërti të shqetësimit toksikologjik.

Gjithashtu, të paraqitet një deklaratë që nuk ka papastërti të rëndësishme toksikologjike, ekotoksikologjike ose mjedisore. Në rastin kur formohen papastërti të shqetësimit toksikologjik, atëherë duhet të sigurohen metodat analitike.

1.5. Tipi dhe kodi i PMB-ve (koncentrat i emulsionuar, pudër e njomë, solucion etj).

Tipi dhe kodi i PMB-së duhet të përcaktohen sipas “Katalogut për tipin e formulave të pesticideve dhe sistemit ndërkombëtar të kodeve (GIFAP Technical Monograph No 2. 1989)”.

Kur në këtë publikim nuk është përcaktuar me saktësi një PMB e veçantë, duhet të jepet një përshkrim i plotë i natyrës fizike dhe strukturës së PMB-së, së bashku me propozimin për përshkrimin e përshtatshëm dhe propozimin për emërtimin e tij.

1.6. Funksioni.

Funksioni i PMB-së duhet të specifikohet si më poshtë:

- akaricid;
- baktericid;
- fungicid;
- herbicid;
- insekticid;
- molluskicid;
- nematocid;
- rregullator i rritjes së bimës;
- zmbrapsës (lagues);
- tërheqës;
- rodenticid;
- gjysëm-kimikat;
- talpicid;
- viricid;
- tjetër (duhet specifikuar).

KREU 2

INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Informacion konfidencial në lidhje me:
Emri (ose kodi) i produktit: _____

Lënda vepruese: _____g /L ose g / kg

1. Identiteti i produktit për mbrojtjen e bimëve

1.2.1. Prodhuesi i PMB-së

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

1.2.2. Prodhuesi i lëndës vepruese

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

1.2.3. Deklarata e pastërtisë (dhe informacioni i detajuar mbi papastërtitë) të lëndës/ve vepruese

Raportet e ekuivalencës: në rastin kur ka pasur një ndryshim në vendin e prodhimit ose specifikimin e lëndës vepruese, atëherë duhet të bëhet referencë në raportin e ekuivalencës. Kur ka informacione lidhur me papastërtitë, ky është informacion konfidencial dhe duhet të raportohet.

1.4. Përbërja e detajuar e PMB-së

1.4.1. Përbërja e produktit për mbrojtjen e bimëve (Përmbajtja e lëndës vepruese dhe formuluesve).

Informacioni mbi përmbajtjen e lëndës vepruese të pastër dhe teknike në PMB paraqitet në këtë paragraf së bashku me informacionet mbi formulantët të PMB-së.

Tabelat më poshtë përmbledhin përmbajtjen e lëndës vepruese të pastër dhe teknike.

Lënda vepruese e pastër

Përmbajtja e lëndës vepruese të pastër:	xx g/L ose g/Kg	Jo e rëndësishme
limitet:	####	#####

Lënda vepruese teknike

Përmbajtja e lëndës vepruese teknike:	xx g/L ose g/Kg	(xx % ë/ë)
limitet:	####	#####

pastërti minimale të lëndës vepruese teknike: ## % ë/ë.

Formuluesit

Në këtë pjesë aplikanti përfshinë një tabelë që përmbledh përmbajtjen e lëndës vepruese (shkallën teknike) dhe formuluesit ose të kalojë referencën e informacionit që paraqitet në pikën 1.4.4. Një tabelë shembulli jepet më poshtë:

Tabela 1.4.1-1: Përbërja e “emri/kodi i produktit”

Emri kimik	CAS no.	Funksioni	g/kg	% e/ë
< lënda vepruese 1>		Herbicid, ose Fungicid, ose...	xxxx 1)	xxxx 1)
< lënda vepruese 2>		Herbicid, ose Fungicid, ose...	xxxx 1)	xxxx 1)
<formulanti 1>				
<formulanti 2>				
<formulanti 3>				
<formulanti 4>				

1.4.2. Kufijtë e certifikuar të secilit komponent

Kufijtë e certifikuar të secilit komponent jepen në këtë rubrikë, nëse është e mundur.

1.4.3. Emrat e zakonshëm dhe numrat e kodeve për lëndën/t vepruese

Emri i zakonshëm të jetë sipas ISO, numrin CAS, NIN EINCS, Nr. CIPAC [kur është e përshtatshme, duhet të theksohet se cili variant (p.sh.: kripë, ester) është i pranishëm.

1.4.4. Detaje bashkë-formuluese: identiteti, struktura, kodet, emri tregtar, specifikimet dhe funksioni

Jepet informacioni i mëposhtëm për formuluesit:

- emri kimik (Indeksi i CA);
- numri CAS;
- numri CIPAC;
- numri EINECS;
- numri i ELINCS;
- Funkzioni; dhe
- informacion tjetër që aplikanti e konsideron të rëndësishëm.

Gjatë përgatitjes së kësaj pjese mund të mos jetë e mundur të sigurohen të gjitha informacionet e kërkuara për formuluesit. Për shembull, nëse një formulues është blerë nga një kompani e palëve të treta, atëherë mund të mos jetë e mundur të jepni informacion mbi strukturën e formuluesit pasi ky mund të jetë informacion konfidencial i biznesit. Në këtë rast informacioni mund të sigurohet direkt nga ndërmarrja e palës së tretë me kërkesë të autoritetit kompetent.

Shënim: kur formulime të ndryshme janë përdorur në studime, atëherë duhet të jepet një deklaratë që shpjegon ngjashmëritë e dy produkteve. Ky informacion mund të sigurohet nën këtë pikë (të dhënat alternative mund të shtohen nën pikat e tjera).

Emri kimik: ##### g / L (##% ë/ë)

Funksioni: ###

Emri i CA: ###

CAS Nr .: ###

EINECS Nr .: ###

Struktura: ###

Emri kimik: ##### g / L (##% ë/ë)

Funksioni: ###

Emri i CA: ###

CAS Nr .: ###

EINECS Nr .: ###

Struktura: ###

1.4.5. Procesi i formulimit

1.4.5.1. Përshkrimi i procesit të formulimit

Në këtë rubrikë jepet përshkrimi i procesit të formulimit.

1.4.5.2. Diskutimi mbi formimin e papastërtive të shqetësimit toksikologjik

Në këtë paragraf jepet informacion për çdo papastërti të shqetësimit toksikologjik.

Gjithashtu, të paraqitet një deklaratë që nuk ka papastërti të rëndësishme toksikologjike, ekotoksikologjike ose mjedisore. Në rastin kur formohen papastërti të shqetësimit toksikologjik, atëherë duhet të sigurohen metodat analitike.

5.2.4. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e papastërtive përkatëse (seksioni 5)

Në këtë paragraf jepet informacioni mbi metodat analitike për papastërtitë, kur është e nevojshme.

5.2.5. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e formulantëve (seksioni 5)

Në këtë paragraf jepet informacioni mbi metodat analitike për përcaktimin e formulantëve, kur është e mundur.

6. Të dhëna për formuluesit

6.1. Fletët e të dhënave për sigurinë (MSDS)

Sigurohet kopje të MSDS për çdo formulues.

Kopjet e Fletëve të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të bashkë-formuluesve përfshihen në këtë dokument.

6.2. Të dhëna toksikologjike të disponueshme për secilin formulues

Informacioni për të dhënat toksikologjike jepet për secilin formulues.

Të dhënat e disponueshme toksikologjike raportohen në MSDS. Klasifikimet rezultuese, bazuar në këto të dhëna, jepen në tabelën vijuese:

Përbërësit (Emri kimik, CAS Nr)	Përmbajtja		Klasifikimi
	g/L	% ë/ë	

DEKLARATA PËR STATUSIN RREGULLATOR TË FORMULANTËVE

Produkti për mbrojtjen e bimëve: _____

Inertet e formulimit	CAS Numer	EINECS	European Pharmacopeia	Directiva 95/2/EC	Directiva 91/248/EC	Directiva 96/335/EEC	Directiva 90/128/EEC

FLETA E TË DHËNAVE TË SIGURISË (MSDS)

Sigurohen MSDS-të për PMB-në dhe formuluesit.

Lista e të dhënave të paraqitura në mbështetje të vlerësimit:

Pika e aneksit	Autor	Viti	Titulli: Burimi: (ku është i ndryshëm nga kompania) Kompania, Raporti Nr. Statusi GLP ose GEP (aty ku është e nevojshme) Botuar ose pabotuar	Kërkohet mbrojtja e të dhënave po/jo	Zotërues

Shënim: Ky informacion do të konsiderohet konfidencial dhe të gjitha detajet duhet të përshkruhen nga aplikanti.

SEKSIONI 2

2. VEÇORITË FIZIKE, KIMIKE DHE TEKNIKE TË PRODUKTIT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

2.1. Veçoritë e jashtme (ngjyra dhe era)

Të jepet përshkrimi i ngjyrës dhe erës, kur ka të tilla, si dhe i strukturës fizike të PMB-së.

2.2. Veçoritë eksplozive dhe oksiduese

Veçoritë eksplozive dhe oksiduese të PMB-së duhet të raportohen në përputhje me metodën e duhur. Një vlerësim teorik i bazuar në strukturë do të pranohet nëse ai plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin për Transportin e Mallrave të Rrezikshëm të Testeve dhe Kriterëve.

2.3. Ndezshmëria dhe vetë-nxehja

Pika e ndezjes së lëngjeve, që përmbajnë tretës të djegshëm, duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën e duhur. Djegshmëria e PMB-ve të ngurtë dhe e gazeve duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodat e duhura, sipas rastit. Një vlerësim teorik i bazuar në strukturë do të pranohet nëse ai plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin për Transportin e Mallrave të Rrezikshëm të Testeve dhe Kriterëve.

2.4. Aciditeti/alkaliteti dhe vlera e pH

Në rastin e PMB-ve, në tretësirë ujore, vlera e pH të përcaktohet dhe raportohet.

Në rastin e PMB-ve, të qëndrueshme dhe jo në tretësirë ujore, të cilat do të aplikohen si hollime ujore, pH i një hollimi 1% të PMB-së të përcaktohet dhe raportohet.

Në rastin e PMB-ve, që janë acide ($\text{pH} < 4$) ose alkaline ($\text{pH} > 10$), aciditeti ose alkaliteti dhe vlera e pH duhet të përcaktohen dhe të raportohen.

2.5. Viskoziteti dhe tensioni sipërfaqësor

Për formulimet e lëngshme viskoziteti përcaktohet në dy vlera të presionit dhe në 20 °C dhe 40 °C dhe raportohet së bashku me kushtet e provës. Tensioni sipërfaqësor përcaktohet në përqendrimin më të lartë.

Për formulimet e lëngshme që përmbajnë hidrokarbure $\geq 10\%$ dhe për të cilat viskoziteti kinematik është më i vogël se $7 \times 10^{-6} \text{ m}^2/\text{sek}$ në 40 °C, tensioni sipërfaqësor i formulimit të pastër përcaktohet në 25 °C dhe raportohet.

2.6. Densiteti relativ dhe densiteti i masës

Densiteti relativ i PMB-ve, të lëngshëm duhet të përcaktohet dhe të raportohet.

Densiteti i masës (i kontaktit) i PMB-ve, në formë pudre ose granulash, duhet të përcaktohen dhe raportohen.

2.7. Stabiliteti i ruajtjes dhe afati i ruajtjes: efektet e temperaturës në karakteristikat teknike të PMB-së.

Qëndrueshmëria e PMB-së, pas magazinimit për 14 ditë, në temperaturë 54 °C, duhet të përcaktohet dhe raportohet. Kur PMB-ja, është e ndjeshme ndaj nxehësisë, mund të jetë e nevojshme të bëhen prova të tjera (p.sh.: 8 javë në 40 °C ose 12 javë në 35 °C ose 18 javë në 30 °C). Konsideratë do t'i kushtohet kryerjes së këtij testi në paketimin e bërë nga i njëjti material si paketim tregtar.

Në qoftë se përmbajtja e lëndës vepruese, pas provës së qëndrueshmërisë ndaj temperaturës, është zvogëluar me më shumë se 5 % ndaj përmbajtjes para provës, duhet të deklarohet përmbajtja minimale dhe të jepet informacion mbi produktet e degraduara.

Në rastin e PMB-ve, të lëngshëm duhet të përcaktohet dhe raportohet efekti i temperaturave të ulëta mbi qëndrueshmërinë.

Duhet të përcaktohet dhe raportohet kohëzgjatja e ruajtjes së PMB-së, në temperaturën e mjedisit. Kur kjo kohë është më e vogël se dy vjet, duhet të raportohet kohëzgjatja e ruajtjes në muaj, duke dhënë specifikimet e duhura për temperaturën e ruajtjes. Testi i qëndrueshmërisë së temperaturës së ambientit duhet të bëhet në paketimin e bërë nga i njëjti material si paketimi tregtar.

Kur është e përshtatshme, do të sigurohen të dhëna për përmbajtjen e papastërtive përkatëse, para dhe pas ruajtjes.

2.8. Karakteristikat teknike të produktit për mbrojtjen e bimëve

Karakteristikat teknike të PMB-së, përcaktohen dhe raportohen në përqendrime të përshtatshme.

2.8.1. Lagështia

Lagështia e PMB-ve të ngurta, që do të treten për përdorim, duhet të përcaktohen dhe të raportohen.

2.8.2. Shkumëzimi i vazhdueshëm

Qëndrueshmëria e shkumëzimit të PMB-së, që do të tretet me ujë, duhet të përcaktohet dhe të raportohet.

2.8.3. Pëzullueshmëria, spontaniteti i shpërndarjes dhe stabiliteti i shpërndarjes

Pëzullueshmëria dhe spontaniteti i shpërndarjes së PMB-ve, shpërndarës në ujë përcaktohen dhe raportohen.

Qëndrueshmëria e shpërndarjes së PMB-ve, siç janë hidro-emulsionet ujore (SE), koncentratet e pezullimit me bazë vaji (OD) ose kokrrizat emulsifikuese (EG) duhet të përcaktohet dhe raportohet.

2.8.4. Shkalla e tretjes dhe stabilitetit të hollimit

Shkalla e shpërbërjes dhe qëndrueshmëria e hollimit të PMB-ve, të tretshme në ujë përcaktohen dhe raportohen.

2.8.5. Madhësia e grimcave të shpërndara, përmbajtja e pluhurit, tretja dhe qëndrueshmëria mekanike

2.8.5.1. Madhësia e grimcave të shpërndara

Në rastin e PMB-ve, të shpërndara në ujë (EDG), duhet të përcaktohet dhe të raportohet prova e sitës së njomë.

Madhësia e grimcave të shpërndara në PMB-të, në formë pudre dhe koncentrate pezull (SC), përcaktohen dhe raportohen.

Gama e madhësive nominale të kokrrizave përcaktohet dhe raportohet.

2.8.5.2. Përmbajtja e pluhurit

Përmbajtja e pluhurit të PMB-ve, granulare përcaktohet dhe raportohet.

Nëse rezultatet tregojnë $> 1\%$ ë/ë pluhur, atëherë madhësia e grimcave të pluhurit të gjeneruar do të përcaktohet dhe raportohet.

2.8.5.3. Tretja

Karakteristikat e tretjes së kokrrizave dhe tabletave të paketuara do të përcaktohen dhe raportohen.

2.8.5.4. Fortësia dhe integriteti

Fortësia dhe integriteti i tabletave përcaktohen dhe raportohen.

2.8.6. Emulsifikueshmëria, ri-emulsifikueshmëria, qëndrueshmëria e emulsionit

Emulsifikueshmëria, qëndrueshmëria e emulsionit dhe ri-emulsifikueshmëria e PMB-ve, të cilat ekzistojnë si emulsione në rezervuarin e spërkatjes, do të përcaktohen dhe raportohen.

2.8.7. Rrjedhshmëria, shpëlarja dhe trazimi (Pluhurueshmëria)

Karakteristikat e mëposhtme përcaktohen dhe raportohen:

- Rrjedhshmëria e PMB-ve, të granuluara;
- Shpëlarja (përfshirë edhe mbetjet e shpëlarjes) e suspensioneve (p.sh. suspension i koncentruar, suspo-emulsionet);

- Pluhurueshmëria e pluhurave të pudrosur pas ruajtjes së përshpejtuar sipas pikës 2.7.

2.9. Përputhshmëria fizike dhe kimike me produkte të tjera përfshirë dhe produktet për mbrojtjen e bimëve me të cilat do të autorizohet përdorimi

Përputhshmëria fizike dhe kimike e përzierjeve të rekomanduara në rezervuare (tanker) përcaktohet dhe raportohet. Mospajtueshmëria e njohur duhet të raportohet.

2.10. Adeherenca dhe shpërndarja tek farat.

Në rastin e PMB-ve, që do të përdoren për trajtimin e farave, duhet të përcaktohet dhe të raportohet adezioni dhe shpërndarja e PMB-së.

2.11. Përmbledhja dhe vlerësimi i të dhënave të paraqitura sipas pikave 2.1. deri 2.10.

Studimet plotësuese të nevojshme për klasifikimin e PMB-ve, sipas rrezikut do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Veçoritë fizike, kimike dhe teknike të dhëna në pikat 2.1 deri 2.11 jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme e cila plotësohet për çdo produkt për mbrojtjen e bimëve.

TABELA PËRMBLEDHËSE

Testi ose studimi dhe pika	Metoda e përdorur / devijimet	Testi material i pastër dhe specifikimet	Gjetjet	GLP Po/Jo	Referenca	Pranueshmëria / komente
Ngjyra, era dhe gjendja fizike (2.1)						
Karakteristikat eksplozive (2.2.1)						
Karakteristikat oksiduese (2.2.2)						
Pika e ndezjes (2.3.1)						
Ndezshmëria (2.3.2)						
Auto- ndezshmëria (2.3.3)						
Aciditeti ose alkaliteti dhe pH (2.4.1)						
pH në hollim 1% të ujit, emulsioni ose shpërndarja (2.4.2)						
Viskoziteti kinematik (2.5.1)						
Viskoziteti dinamik (2.5.2)						
Tensioni sipërfaqësor (2.5.3)						
Dendësia relative (2.6.1)						
Dendësia e masës ose lidhjes (2.6.2)						
Stabiliteti i ruajtjes pas 14 ditësh në 54° C (2.7.1)						
Stabiliteti pas ruajtjes për periudha/dhe ose temperatura të tjera (2.7.2)						
Përmbajtja minimale pas testimit të qëndrueshmërisë së nxehtësisë (2.7.3)						
Efektet e temperaturave të ulëta në qëndrueshmëri (2.7.4)						

Testi ose studimi dhe pika	Metoda e përdorur / devijime t	Testi material i pastër dhe specifikimet	Gjetjet	GLP Po/Jo	Referenca	Pranueshmëria / komente
Jetëgjatësia e ruajtjes në temperaturën e ambientit (2.7.5)						
Jetëgjatësia e muajve (nëse ka më pak se 2 vjet) (2.7.6)						
Shkrirja (2.8.1)						
Këmbëngulja e shkumës (2.8.2)						
Avullimi (2.8.3.1)						
Spontaniteti i shpërndarjes (2.8.3.2)						
Stabiliteti i hollimit (2.8.4)						
Testi i sitës së thatë (2.8.5.1)						
Testi i sitës së lagur (2.8.5.2)						
Shpërndarja e madhësisë së grimcave (2.8.6.1)						
Gama e madhësive nominale të kokrrizave (2.8.6.2)						
Përmbajtja e pluhurit (2.8.6.3)						
Madhësia e grimcave të pluhurit (2.8.6.4)						
Shkrifshmëria dhe fërkimi (2.8.6.5)						
Emulsiushmeria (2.8.7.1)						
Stabiliteti i emulsionit (2.8.7.2)						
Ri-Emulsiushmeria (2.8.7.3)						
Stabiliteti i emulsioneve të holluara (2.8.7.4)						
Stabiliteti i emulsioneve (2.8.7.5)						
Flowability (2.8.8.1)						
Pourabiliteti (përfshirë mbetjet e shpëlara) (2.8.8.2)						
Qëndrueshmëria pas ruajtjes së përsheptuar (2.8.8.3)						
Përputhshmëria fizike e përzierjeve të tanker (2.9.1)						
Përputhshmëria kimike e e përzierjeve të tanker (2.9.2)						
Ngjitja e farave (2.10.1)						
Shpërndarja në farë (2.10.2)						
Përzierja (2.11)						
Dobësimi dielektrik (2.12)						

Testi ose studimi dhe pika	Metoda e përdorur / devijimet	Testi material i pastër dhe specifikimet	Gjetjet	GLP Po/Jo	Referenca	Pranueshmëria / komente
Karakteristikat e gërryerjes (2.13)						
Materiali enes (2.14)						
Studime të tjera/speciale (2.15)						

SEKSIONI 3

3. Të dhëna mbi aplikimin (përdorimin)

Të dhënat për aplikimin duhet të parashtrohen (paraqiten) dhe duhet të jenë në përputhje me praktikatat e mira të mbrojtjes së bimëve.

3.1. Fushat e përdorimit

Fushat e përdorimit, ekzistuese dhe të propozuara, duhet të specifikohen si vijon:

a) përdorim në tokë, si bujqësi, hortikulturë, pyje dhe vreshtari, kultura të mbrojtura, kontrolli i barërave të këqija në zona të pa kultivuara;

b) kopshtari;

c) bimë dhe lule shtëpie;

ç) praktika të ruajtjes së produkteve bimore;

d) të tjera (të specifikohet).

3.2. Efektet e organizmat e dëmshëm

Duhet të tregohet natyra e efekteve mbi organizmat e dëmshëm:

a) veprim nëpërmjet kontaktit;

b) veprim nëpërmjet stomakut;

c) veprim nëpërmjet thithjes me frymëmarrje;

ç) veprim fungitoksik;

d) veprim fungostatik;

dh) desikant;

e) inhibitor riprodhimi;

ë) të tjera (të specifikohet).

Për më tepër, do të specifikohet nëse PMB-ja është sistemike apo jo në bimë.

3.3. Detaje të qëllimit të përdorimit

Detajet e përdorimit të synuar do të paraqiten, përfshirë, informacionin e mëposhtëm:

3.3.1. Detaje të përdorimeve ekzistuese dhe të synuara

Në këtë paragraf jepet një përmbledhje të përdorimeve ekzistuese/të synuara (bimë ose produkte bimore për t'u mbrojtur).

3.3.2. Detaje të organizmave të dëmshëm kundër të cilave sigurohet mbrojtje

Në këtë paragraf jepen informacione përmbledhëse (llojet e organizmave të dëmshëm që kontrollohen).

3.3.3. Efektet e arritura

Informacione përmbledhëse (p.sh. efektet e arritura si: shtypja (pengimi) e mbirjes (mugullimit) ose pengimi i daljes së filizave, ngadalësimi i pjekjes, zvogëlimi i gjatësisë së kërcellit, rritja e fuqisë fertilizuese), etj., jepen në këtë paragraf.

3.4. Doza e aplikimit dhe përqendrimi i lëndës vepruese

Për çdo metodë aplikimi dhe për çdo përdorim, duhet të jepet doza e përdorimit për njësi (ha, m², m³) të trajtuar, me gram ose kilogram për PMB-të dhe lëndët vepruese.

Normalisht, doza e aplikimit duhet të jepet në:

- gr, ml, kg ose lit/ha;
- kg ose lit/m³;
- gr, ml, kg ose lit/ton;

Për kulturat e mbrojtura dhe në kopshtari, doza e përdorimit duhet të jepet në:

- gr, ml, kg ose lit/100 m²;
- gr, ml, kg ose lit/m³.

Përmbajtja e lëndëve vepruese, duhet të raportohet, sipas rastit, në gr ose ml/litër, gr ose ml/kg.

3.5. Metoda e aplikimit, lloji i pajisjeve të përdorura dhe vëllimi i holluesve

Metoda e propozuar e aplikimit, duhet të përshkruhet plotësisht, duke treguar tipin e pajisjeve, që do të përdoren, si dhe tipin dhe volumin e tretësit, që do të përdoret për njësi sipërfaqe ose volumi.

3.6. Numri dhe koha e aplikimit, dhe zgjatja e mbrojtjes

Të raportohet numri maksimal i aplikimeve, që do të kryhen si dhe koha e tyre. Kur është e nevojshme, duhet të tregohet edhe stadi i rritjes së bimës, që do të mbrohet si dhe stadi i zhvillimit të organizmave të dëmshëm. Kur është e mundur, duhet të tregohet edhe intervali në ditë ndërmjet aplikimeve.

Të tregohet kohëzgjatja e mbrojtjes, që sigurohet nga secili aplikim si dhe numri maksimal i aplikimeve, që do të përdoren.

3.7. Periudhat e nevojshme të pritjes ose masa të tjera parandaluese për të evituar efektet fitotoksike në konvejerin e mbjelljeve

Kufizimet për zgjedhjen e kulturave pasardhëse, nëse ka, do të përcaktohen.

3.7.1. Numri maksimal i aplikacioneve dhe koha e tyre

Jepen informacione përmbledhëse të numrit maksimal të aplikacioneve dhe koha e tyre.

3.7.2. Fazat e rritjes së bimëve ose bimëve që duhet të mbrohen

Informacione përmbledhëse mbi fazat e rritjes së bimëve ose bimëve që duhet të mbrohen.

3.7.3. Fazat e zhvillimit të organizmit të dëmshëm në fjalë

Jepen informacione përmbledhëse mbi fazat e zhvillimit të organizmit të dëmshëm në fjalë.

3.7.4. Kohëzgjatja e mbrojtjes së secilit aplikim

Jepen informacione përmbledhëse mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së secilit aplikim.

3.7.5 Kohëzgjatja e mbrojtjes e siguruar nga numri maksimal i aplikacioneve

Jepen informacione përmbledhëse mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes e siguruar nga numri maksimal i aplikacioneve.

3.8. Instruksionet e propozuara për përdorim.

Duhet të sigurohen instruksionet (udhëzimet) e propozuara për përdorimin e PMB-së, të cilat duhet të shtypen në etiketa dhe fletë palosje.

SEKSIONI 4

4. Informacione të mëtejshme mbi produktet për mbrojtjen e bimëve

4.1. Paketimi dhe përputhshmëria me PMB-në

Natyra dhe karakteristikat e paketimit:

Informacioni në lidhje me llojin, dimensionet, kapacitetin, madhësinë e hapjes, llojin e mbylljes, forcën, rrjedhshmërinë, rezistencën ndaj transportit normal dhe trajtimit, rezistencën ndaj dhe përputhshmërisë me përmbajtjen e paketimit, dorëzohen për t'u vlerësuar.

4.1.1. Përshkrimi dhe specifikimi i paketimit

Në këtë paragraf të jepet përshkrimi i materialit të paketimit (lloji, materialet, madhësia, madhësia e qafës së shishes, etj.), nëse kontejneri është i rimbushshëm ose i kthyeshëm dhe detaje të çdo gjëje që është e pazakontë.

4.1.2. Përshtatshmëria e paketimit dhe mbylljeve

Të jepet informacioni mbi përshtatshmërinë e materialit të paketimit (forca, prova e rrjedhjes dhe rezistenca ndaj transportit dhe trajtimit), duke përfshirë standardet/udhëzimet që janë përdorur (p.sh. ADR, RID, kodit IMDG).

4.1.3. Rezistenca e materialit paketues ndaj përmbajtjes së tij

Të jepet informacioni i rezistencës së materialit për paketim, duke përfshirë udhëzimet që janë përdorur.

4.2. Procedurat për pastrimin e pajisjeve të aplikimit

4.2.1. Procedurat për pastrimin e pajisjeve të aplikimit dhe veshjeve mbrojtëse

Të jepet përmbledhje e procedurave për pastrim.

Menjëherë pas përdorimit, pastroni plotësisht pajisjet e tretësirës. Kullojeni plotësisht sistemin dhe shpëlajeni rezervuarin me solucion, dy deri në tre herë me ujë të pastër derisa shkuma dhe të gjitha gjurmët e produktit të jenë hequr.

4.2.2. Efektiviteti i procedurave të pastrimit

Të jepet informacion mbi efektivitetin e procedurës së propozuar të pastrimit.

4.3. Periudhat e ri-hyrjes për të mbrojtur njeriun, bagëtinë dhe mjedisin

4.3.1. Intervali i para-korries (në ditë) për secilën kulturë përkatëse

Të jepet informacion përmbledhës.

Për detaje të plota të të gjitha përdorimeve, ju lutemi referojuni përdorimeve të synuara.

4.3.2. Periudha e rikthimit (brenda ditëve) për bagëtinë, në zonat që do të kullohen

Të jepet informacioni i duhur, nëse kërkohet.

4.3.3. Periudha e ri-hyrjes (në orë ose ditë) nga njeriu te të lashtat, ndërtesat ose hapësirat e trajtuara

Të jepet informacioni, i cili përmbledh periudhat e nevojshme të ri-hyrjes për të mbrojtur punëtorët.

4.3.4. Periudha e mbajtjes (në ditë) për lëndët ushqyese të kafshëve

Të jepet informacioni i duhur nëse kërkohet.

4.3.5. Periudha e pritjes (në ditë) midis aplikimit dhe lëvizjes me dorë të produkteve të trajtuara

Të jepet informacion, i cili përmbledh periudhat e nevojshme të rihyrjes për të mbrojtur punëtorët.

4.3.6. Periudha e pritjes (brenda ditëve) midis aplikimit të fundit dhe mbjelljes ose trapiantimit të kulturave që pasojnë

Të jepet informacioni i duhur, nëse kërkohet.

4.3.7. Informacion mbi kushtet specifike nën të cilat preparati mund ose nuk mund të përdoret

Të jepet informacioni i duhur, nëse kërkohet.

4.4. Deklarata e rreziqeve që lindin dhe metodat dhe masat paraprake të rekomanduara dhe procedurat e trajtimit për të minimizuar ato rreziqe

Të jepet informacioni i duhur, nëse kërkohet.

Pikat 4.3.1 deri 4.3.9 janë të gjitha të përfshira në fletën e të dhënave të sigurisë së produktit

4.4.1. Magazinimi ne depo

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.2. Ruajtja e nivelit të përdoruesit

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.3. Transporti

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.4. Zjarri

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.5. Natyra e veshjeve mbrojtëse të propozuara

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.6. Karakteristikat e veshjeve mbrojtëse të propozuara

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.7. Përshtatshmëria dhe efektiviteti i veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.8. Procedurat për të minimizuar gjenerimin e mbeturinave

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.4.9. Produkte të djegies që mund të gjenerohen në rast zjarri

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.5. Procedurat e hollësishme për përdorim në rast të një aksidenti gjatë transportit, ruajtjes ose përdorimit

Pikat 4.4.1 deri 4.4.5 janë të gjitha të përfshira në fletën e të dhënave të sigurisë së produktit. Përndryshe, informacioni i përfshirë në fletën e të dhënave të sigurisë mund të përmbledhet më poshtë nën secilën pikë.

4.5.1. Përmbajtja e derdhjeve

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.5.2. Dekontaminimi i zonave, automjeteve dhe ndërtesave

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.5.3. Shkarkimi i paketimit të dëmtuar, adsorbentëve dhe materialeve të tjera

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.5.4. Mbrojtja e punonjësve të urgjencës dhe kalimtarëve

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.5.5. Masat e ndihmës së parë

Referojuni fletës së të dhënave të sigurisë për “kodi i produktit”.

4.6. Procedura e neutralizimit për përdorim në rast të derdhjes aksidentale

Të jepet një deklaratë e përgjithshme nëse neutralizimi është një procedurë e përshtatshme për përdorim në rast të derdhjes aksidentale. Nëse neutralizimi mund të përdoret, atëherë informacioni më i detajuar duhet të jepet në pikat 4.6.1 deri 4.6.6.

4.6.1. Detaje të procedurave të propozuara për sasi të vogla

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.6.2. Vlerësimi i produkteve të neutralizimit (sasi të vogla)

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.6.3. Procedurat për deponimin e sasive të vogla të mbeturinave të neutralizuara

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.6.4. Detaje të procedurave të propozuara për sasi të mëdha

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.6.5. Vlerësimi i produkteve të neutralizimit (sasi të mëdha)

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.6.6. Procedurat për deponimin e sasive të mëdha të mbeturinave të neutralizuara

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.7. Sjellja pirolitike e lëndës vepruese

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

Një referencë mund të bëhet në legjislacionin që përcakton kushtet e kontrolluara për djegie. Të shtohet ndonjë kërkesë të veçantë për djegie, p.sh., në rastin kur përmbajtja e halogjenit është më e madhe se 1% dhe më pak se 60%.

4.8. Procedurat e asgjësimit të PMB-së

4.8.1. Udhëzime të hollësishme për asgjësimin e sigurt të produktit dhe paketimin e tij

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.8.2. Metodat e tjera nga djegia e kontrolluar për asgjësim

Të jepet informacion, aty ku është e nevojshme.

4.9. Studime të tjera/speciale

Të jepet një përmbledhje për çdo studim tjetër që është kryer dhe që dëshironi të konsideroni.

SEKSIONI 5

5. Metodat analitike

Për metodat analitike të përdorura për gjenerimin e të dhënave ose për qëllime të tjera, aplikanti duhet të japë një justifikim për metodat e përdorura; aty ku është e nevojshme një udhëzim i veçantë do të hartohet për metoda të tilla, mbi bazën e të njëjtave kërkesa, siç përcaktohet për metodat për kontrollin pas regjistrimit dhe për qëllime monitoruese.

Përshkrimet e metodave duhet të jepen dhe të përfshijnë hollësi të pajisjeve, materialeve dhe kushteve të përdorimit.

Për të qenë të zbatueshme, këto metoda duhet të përdorin përafrimin më të thjeshtë, të përfshijnë kosto minimale dhe të kërkojnë pajisje përgjithësisht të përshtatshme.

Nëse kërkohet nga autoriteti kompetent, të sigurohen standardet analitike të lëndës vepruese të pastër dhe të PMB-së;

Zbatohen për këtë qëllim përcaktimet vijuese:

i) Specificitet

Specificiteti është aftësia e një metode për të ndarë nga të tjerat lëndën, objekt të analizave;

ii) Linearitet

Linearitet kuptohet aftësia e metodës, për një gamë të dhënë, për të nxjerrë një korrelacion linear të pranueshëm mes rezultateve dhe përqendrimit të lëndës, që analizohet në kampionet;

iii) Saktësi (përpikmëri)

Saktësia e një metode është shkalla, në të cilën vlera e përcaktuar e lëndës, që analizohet në një kampion, korrespondon me vlerën referuese të pranuar (psh. në referim me ISO 5725);

iv) Qartësi

Qartësia është përputhshmëria mes rezultateve të provave të pavarura, të siguruara në kushtet e parashkruara;

v) Përsëritshmëri

Përsëritshmëria është saktësia në kushte përsëritjeje, pra në kushtet në të cilat, rezultatet e provave të pavarura janë siguruar me të njëjtën metode në materialin e provës identike, të të njëjtin laborator, nga i njëjti operator, me të njëjtën aparaturë, në intervale kohore të shkurtëra;

vi) Riprodhueshmëri

Riprodhueshmëria nuk kërkohet për lëndën vepruese, të prodhuar (për përcaktimin e saj shih ISO 5725).

Metodat do të sigurohen, me një përshkrim të plotë, për përcaktimin e:

- lëndës vepruese dhe/ose varianti në PMB;
- bashkë-formuluesve përkatës, kur kërkohet.

Metodat, të cilat duhet të përshkruhen në mënyrë të plotë, duhet të jepen për përcaktimin e lëndës vepruese në PMB. Në rastin kur PMB-ja, përmban më shumë se një lëndë vepruese, duhet të jepet një metodë, që lejon përcaktimin e çdonjërës, në prani të tjetrës. Në qoftë se nuk është paraqitur një metodë e kombinuar, duhet të konstatohen arsyet teknike.

Duhet të raportohet zbatueshmëria e metodës ekzistuese CIPAK. Në rast të përdorimit të një metode CIPAC, të dhënat e mëtejshme të vlefshmërisë nuk do të kërkohen, por shembull të kromatografisë duhet të dorëzohen, kur është e mundur.

Metodat duhet të jepen gjithashtu për përcaktimin në PMB të ndotjeve, që lidhen me të, në qoftë se përbërja e PMB-së, është e tillë që, mbi bazën e gjykimit teorik, ndotje të tilla mund të krijohen nga procesi i prodhimit të tij ose nga shkatërrimi gjatë ruajtjes.

Duhet të paraqiten metodat për përcaktimin e përbërësve të PMB-së, në qoftë se kërkohet.

5.1. Standardet dhe kampionet analitike

5.1.1. Mostrat e preparatit

Mostrat do të paraqiten sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

5.1.2 Standardet analitike për substancën e pastër aktive

Mostrat do të paraqiten sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

5.1.3. Mostrat e substancës aktive siç prodhohen

Mostrat do të paraqiten sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

5.2. Metodat për analizën e produktit për mbrojtjen e bimëve

Të jepet një përmbledhje e metodave të disponueshme.

5.2.1. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e substancës aktive në PMB

Të jepet informacion mbi metodat analitike dhe vlefshmërinë e tyre (përfshini informacione nëse metodat janë vlerësuar tashmë për lëndët vepruese).

Metoda

Një metodë analitike është zhvilluar për përcaktimin e “lëndës vepruese”, në “kodin e produktit”.

Metoda e mëposhtme analitike për përcaktimin e lëndës vepruese në PMB të kryer në “kodin e produktit” është vlerësuar në rishikimin e BE-së. Raporti është i bashkëngjitur me këtë parashtresë, por meqenëse studimi është vlerësuar i pranueshëm gjatë rishikimit të BE-së, një përmbledhje e plotë e studimit duhet dhënë.

Raporti:	5.2.1/01, Vendosi emrin e autorit, shënoni vitin
Titulli:	
Dokumenti nr:	
Udhëzimet:	
GLP	

Përfundim: Metoda është e pranueshme.

Ose: Metoda e mëposhtme analitike për përcaktimin e lëndës vepruese në PMB të kryer në “kodin e produktit” nuk është shqyrtuar më parë dhe është dhënë në mbështetje të këtij vlerësimi.

Komente të studimit: 5.2.1/01	
Pika përfundimtare e miratuar: 5.2.1/01	

Validimi

Validimi i plotë i “method code” është i rregulluar mirë.

5.2.2. Për preparatet që përmbajnë më shumë se një substancë aktive, përshkrimi i metodës për përcaktimin e secilës në prani të tjetrit

Të jepet informacion mbi metodat analitike dhe vlefshmërinë e tyre (përfshini informacione nëse metodat janë vlerësuar tashmë për lëndët vepruese).

Nëse studimi nuk është vlerësuar më parë, jepni përmbledhjen e studimit.

Për udhëzime se si të plotësoni këtë pikë, referojuni pikës 5.2.1.

5.2.3. Zbatueshmëria e metodave ekzistuese CIPAC

Të jepet informacion mbi metodat CIPAC, nëse është e mundur.

Ose: Nuk ka asnjë metodë CIPAC në dispozicion për përcaktimin e “lëndës vepruese”.

5.2.4. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e papastërtive përkatëse

Të jepen detaje në metodat analitike për papastërtitë.

Në përgjithësi, informacioni mbi papastërtitë konsiderohet si informacion konfidencial sipas përcaktimeve të bëra në kreun 2, të seksionit 1, megjithatë nëse papastërtia përcaktohet si papastërti përkatëse, atëherë këto informacione nuk konsiderohen të jenë konfidenciale dhe informacioni duhet të sigurohet këtu.

5.2.5. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e formulantëve

Të jepen detaje në metodat analitike për formuluesit (kur është e nevojshme).

Sipas legjislacionit aktual të BE-së, metodat mbi formuluesit nuk kërkohen, megjithatë nëse një formulues përcaktohet si i rëndësishëm për toksicitetin (mjedisin, shëndetin), atëherë duhet të sigurohet një metodë. Ky informacion nuk konsiderohet të jetë konfidencial dhe informacioni duhet të sigurohet këtu.

5.3. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e mbetjeve

Specificiteti i metodave përcaktohet dhe raportohet. Metodat e vërtetuara të konfirmimit do të dorëzohen, nëse është e përshtatshme.

Përcaktohet dhe raportohet lineariteti, rikuperimi dhe saktësia (përsëritshmëria) e metodave.

Të dhënat do të gjenerohen në LOQ dhe/ose nivelet e mundshme të mbetjes ose dhjetë herë LOQ. LOQ do të përcaktohet dhe raportohet për secilin përbërës në përkufizimin e mbetjeve.

5.3.1. Përshkrimi i metodave analitike për përcaktimin e mbetjeve në kulturat

Të jepet informacion mbi metodat analitike për secilën kulturë/matricë.

Përfundime të BE-së: Metoda analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në kulturat.

Kultura/Matrica	Metoda e pranuar e BE-së (SANCO/xxxxx/xx-xx/xx/xxxx) ose: (EFSA No. Raporti Shkencor (viti))	Metoda e propozuar *

Jepni arsyetimin për metodat e reja dhe studimin ndër referencë.

Përmbledhje

Të gjitha metodat analitike janë të dhëna për lëndët vepruese dhe janë dhënë në rishikimin e BE-së për “lëndën vepruese” dhe konsiderohen të përshtatshme.

Tabela 5.3.1-1 Metodat analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në kulturat.

Kultura/Matrica	Studime	Metoda analitike	Metoda monitoruese	Referenca
a				

	Metoda			
	Validimi			
	Metoda			
	Validimi			

Të jepet një përmbledhje e të dhënave shtesë, siç kërkohet:

Studimi/et e mëposhtëm analitik i mbetjeve në “kultura”/”matrica” nuk janë shqyrtuar më parë dhe janë dhënë në mbështetje të këtij vlerësimi. Të dhënat e lëndëve vepruese duhet të përfshihen këtu dhe duhet të sigurohet një referencë e kryqëzuar në pikën e duhur të të dhënave.

Raporti:	1 5.3.1/01, Vendosni emrin e autorit, vendosni vitin
Përfshini nëse kërkohet; Pika e të dhënave	x-referencë përkatëse në pikën e të dhënave nëse paraqet të dhëna të lëndëve vepruese
Titulli:	
Dokumenti No:	
Udhëzimet:	
GLP	

Të jepet një përmbledhje e studimit, rendisni parametrat e metodës, etj.

Komente të studimit: 5.3.1/01	
Pika përfundimtare e miratuar: 5.3.1/01	

5.4. Përshkrimi i metodave për analizën e tokës

Të jepet informacion mbi metodat analitike të tokës për lëndën vepruese dhe metabolitët.

Përfundime të BE-së: Metoda analitike për mbetjet e “lëndën vepruese” në tokë.

Matrica	Metoda e pranuar e BE-së (SANCO/xxxxx/xx xx/xx/xxxx) ose: (EFSA No. Raporti Shkencor (viti))	Metoda e propozuar *

Shtoni arsyetimin për sigurimin e metodës së re dhe studimin ndër referencë.

Përmbledhje

Të gjitha metodat analitike janë të dhëna për lëndët vepruese dhe janë dhënë në rishikimin e BE-së për “lëndën vepruese” dhe konsiderohen të përshtatshme.

Tabela 5.4-1 Metodat analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në tokë

Matrica	Studime	Metoda analitike	Metoda monitoruese	Referenca
	Metoda			
	Validimi			

Të jepet përmbledhje e të dhënave shtesë, siç kërkohet:

Studimi/et e mëposhtëm analitik të mbetjeve në “matrica” nuk janë shqyrtuar më parë dhe janë dhënë në mbështetje të këtij vlerësimi. Të dhënat e lëndëve vepruese duhet të përfshihen këtu dhe duhet të sigurohet një referencë e kryqëzuar në pikën e duhur të të dhënave.

Raporti:	1 5.4.1/01, Vendosni emrin e autorit, vendosni vitin
----------	--

Përfshini nëse kërkohet; Pika e të dhënave	x-referencë përkatëse në pikën e të dhënave nëse paraqet të dhëna të substancave aktive
Titulli:	
Dokumenti No:	
Udhëzimet:	
GLP	

Të jepet përmbledhje e studimit, rendisni parametrat e metodës, etj.

Komente të studimit: 5.4.1/01	
Pika përfundimtare e miratuar: 5.4.1/01	

5.5. Përshkrimi i metodave për analizën e ujit

Të jepet informacion mbi metodat analitike të ujit për lëndën/t vepruese dhe metabolitët përkatës.

Përfundime të BE-së: Metoda analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në ujë.

Matrica	Studime	Metoda analitike	Metoda monitoruese	Referenca
	Metoda			
	Validimi			

Shtoni arsyetimin për sigurimin e metodës së re dhe studimin ndër referencë.

Përmbledhje

Të gjitha metodat analitike janë të dhëna për lëndët vepruese dhe janë dhënë në rishikimin e BE-së, për “lëndën vepruese” dhe konsiderohen të përshtatshme.

Tabela 5.5-1 Metodat analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në ujë.

Matrica	Studime	Metoda analitike	Metoda monitoruese	Referenca
	Metoda			
	Validimi			

Të jepet përmbledhje e të dhënave shtesë siç kërkohet:

Studimi/et e mëposhtëm analitik të mbetjeve në “matricën” nuk janë shqyrtuar më parë dhe janë dhënë në mbështetje të këtij vlerësimi. Të dhënat e lëndëve vepruese duhet të përfshihen këtu dhe duhet të sigurohet një referencë e kryqëzuar në pikën e duhur të të dhënave.

Raporti:	1 5.5.1/01, Vendosni emrin e autorit, vendosni vitin
Përfshini nëse kërkohet; Pika e të dhënave	x-referencë përkatëse në pikën e të dhënave nëse paraqet të dhëna të substancave aktive
Titulli:	
Dokumenti No:	
Udhëzimet:	
GLP	

Të jepet përmbledhje e studimit, rendisni parametrat e metodës, etj.

Komente të studimit: 5.5.1/01	
Pika përfundimtare e miratuar: 5.5.1/01	

5.6. Përshkrimi i metodave për analizën e ajrit

Të jepet informacion mbi metodat analitike të ajrit për lëndën/t vepruese dhe metabolitët përkatës.

Përfundime të BE-së: Metoda analitike për mbetjet e “lëndës vepruese” në ajër.

Matrica	Studime	Metoda analitike	Metoda monitoruese	Referenca
	Metoda			
	Validimi			

Shtoni arsyetimin për sigurimin e metodës së re dhe studimin ndër referencë.

Përmbledhje

Studimet mbi shkallën e degradimit aerob të lëndës vepruese raportohen për të paktën katër tipa të tokës. Karakteristikat e tokës do të jenë të krahasueshme me ato të përdorura për studimet aerobike të kryera në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese. Vlerat e besueshme të DegT50 dhe 90 do të jenë në dispozicion për së paku katër tokë të ndryshme.

Studimet mbi shkallën e degradimit anaerob të lëndës vepruese do të kryhen duke përdorur të njëjtën procedurë dhe tokë të krahasueshme për studimin anaerob të kryer në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Vlerat e besueshme të DegT50 dhe 90 për metabolitet, produktet e degradimit dhe reagimit duhet të sigurohen për të paktën tre toka nga studimet në kushte aerobike.

Zgjatja e studimit është normalisht 120 ditë, përveç rasteve kur, më shumë se 90 % e lëndës vepruese, është shkatërruar përpara se kjo periudhë të mbarojë.

Udhëzuesi i provës

SETAC-Procedurat për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe ekotoksicitetin e PMB-ve.

9.1.1.2. Studimet fushore

9.1.1.2.1. Studimet për përhapjen në tokë

Studimet për përhapjen në tokë duhet të sigurojnë vlerësimet më të mira të mundshme të kohës, të arritura për përhapjen e 50 % dhe 90 % (DT50f dhe DT90f), dhe nëse është e mundur koha e marrë për degradimin e 50% dhe 90% (fusha DegT50 dhe fusha DegT90), e lëndës vepruese në kushte fushore. Përhapja dhe sjellja e PMB-ve në tokë, duhet të shqyrtohet, përveçse në rastet kur është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitet përkatëse, produktet e degradimit dhe të reagimit, në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Kushtet dhe udhëzimi i provës

Studimet individuale mbi një gamë të tokave përfaqësuese (normalisht të paktën katër lloje të ndryshme në vendndodhje të ndryshme gjeografike) do të vazhdojnë derisa të paktën 90% e sasisë së aplikuar të ketë shpërndarë nga toka ose të jetë shndërruar në substanca që nuk janë objekt i shqyrtimit.

9.1.1.2.2. Studimet për mbetjen në tokë

Studimet për mbetjen në tokë duhet të sigurojnë vlerësime të niveleve të mbetjes në tokë, në momentin e korrijës ose në kohën e mbjelljes së bimëve pasardhëse.

Studimet e mbetjes në tokë duhet të raportohen, përveçse në rastet kur është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitet përkatëse, produktet e degradimit dhe të reagimit, në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Kushtet e provës

Studimet afatgjata në terren do të kryhen në të paktën dy toka përkatëse në vende të ndryshme gjeografike dhe përfshijnë aplikime të shumta.

Udhëzuesi i provës

SETAC-Procedurat për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe ekotoksicitetin e PMB-ve.

9.1.1.2.3. Studimet për grumbullimin në tokë

Provat duhet të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar mundësinë e grumbullimit të mbetjeve të lëndës vepruese dhe të metaboliteve përkatëse, produkteve të degradimit dhe të reagimit.

Studimet për grumbullimin në tokë duhet të raportohen, përveç rasteve kur është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitet përkatëse, produktet e degradimit dhe të reagimit, në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Kushtet e provës

Aplikohen të njëjtat udhëzime, siç jepen në kërkesat për lëndën vepruese.

Udhëzuesi i provës

SETAC-Procedurat për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe ekotoksicitetin e PMB-ve.

9.1.2. Lëvizja në tokë

Informacioni i vënë në dispozicion duhet të sigurojë të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar lëvizshmërinë dhe potencialin e rrjedhjes së lëndës vepruese dhe metabolitëve, produkteve të degradimit dhe reagimit.

9.1.2.1. Studimet laboratorike

Lëvizja e PMB-ve në tokë duhet të shqyrtohet, përveçse rasteve kur është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Kushtet e provës

Zbatohen të njëjtat dispozita siç parashikohen në kërkesat për lëndën vepruese.

Udhëzuesi i provës

SETAC-Procedurat për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe ekotoksicitetin e PMB-ve.

9.1.2.2. Studimet Lysimeter ose studimet e kullimit në terren

Duhet të sigurohen të dhëna mbi:

- ndryshueshmërinë e PMB-së në tokë;
- mundësinë për kullimin e ujit tokësor;
- shpërndarjen e mundshme në tokë.

Këto studime duhet të paraqiten, përveçse në rastet kur është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitet përkatëse, produktet e degradimit dhe të reagimit, në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

9.1.2.3. Studimet e shpëlarjes në terren

Studimet e shpëlarjes në terren do të paraqiten, kur është e nevojshme, për të dhënë informacione mbi:

- lëvizshmërinë në tokë,
- potencialin për të kulluar në ujë nëntokësor,
- shpërndarjen e mundshme në tokë.

9.1.3. Vlerësimi i përqendrimeve në tokë

Në vlerësimet PECs të tokës, duhet të lidhen me të dyja, me një aplikim të vetëm dhe me masat më të larta të aplikimit, për të cilat regjistrimi është kërkuar, dhe numrin maksimal si dhe masat më të larta të aplikimit, për të cilat regjistrimi është kërkuar, për çdo tokë të përshtatshme të provuar, dhe janë shprehur në mg të lëndës vepruese dhe metabolitëve përkatëse, produkteve të degradimit dhe të reagimit, për kg të tokës.

Faktorët, që duhet të merren në konsideratë në realizmin e vlerësimeve PECs, lidhen me aplikimin direkt dhe indirekt në tokë, me kullimin, rrjedhjen dhe, përfshijnë procese të tilla si,

avullimi, thithja, hidroliza, fotoliza dhe degradimi aerobik dhe anaerobik. Thellësi të përshtatshme të shtresave të tokës do të përdoren në varësi të metodës së aplikimit dhe kultivimit të tokës. Kur mbulesa tokësore është e pranishme në kohën e aplikimit, ndikimi i interceptimit të të korrave në uljen e ekspozimit të tokës mund të përfshihet në vlerësime.

9.2. Fati dhe sjellja në ujë dhe sedimente.

9.2.1. Mineralizimi aerobik në ujërat sipërfaqësorë

Qëndrueshmëria dhe sjellja e PMB-ve në ujëra të hapur (ujëra të ëmbël, grykëderdhje dhe detare) do të investigohen përveç nëse është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitët, produktet e degradimit dhe reagimit në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Testi raportohet nëse aplikanti nuk tregon se ndotja e ujerave të hapur nuk do të ndodhë.

Kushtet e provës

Shkalla e degradimit dhe rruga ose rrugët duhet të raportohen ose për një sistem provë 'te hapur' ose për një sistem 'të ndërprerë të sedimentit'. Kur është e nevojshme, do të përdoren sisteme shtesë të provës, të cilat ndryshojnë në lidhje me përmbajtjen organike të karbonit, strukturën ose pH.

Rezultatet e marra do të paraqiten në formën e vizatimeve skematike që tregojnë rrugët e përfshira, dhe në formën e bilanceve që tregojnë shpërndarjen e etiketës radio në ujë dhe, kur është e nevojshme, sedimentit si funksion i kohës, midis:

- lëndës vepruese;
- CO₂;
- komponimeve të paqëndrueshme përveç CO₂;
- produkteve individuale të identifikuara të transformimit;
- substancave të nxjerra që nuk identifikohen; dhe
- mbetjeve jo të ekstraktueshme në sediment.

Kohëzgjatja e studimit nuk duhet të kalojë 60 ditë, përveç nëse zbatohet procedura gjysmë e vazhdueshme me rinovimin periodik të pezullimit të testit. Sidoqoftë, periudha për testin e serisë mund të zgjatet në maksimum 90 ditë, nëse degradimi i substancës së provës ka filluar brenda 60 ditëve të para.

9.2.2. Studim i ujit/sedimentit

Qëndrueshmëria dhe sjellja e PMB-ve në sistemet ujore do të investigohet përveç nëse është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra mbi lëndën vepruese dhe metabolitët, produktet e degradimit dhe reagimit në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Kushtet e provës

Rruga e degradimit ose shtigjet duhet të raportohen për dy sisteme uji/sedimenti. Dy sedimentet e zgjedhura ndryshojnë në lidhje me përmbajtjen organike të karbonit dhe strukturën, dhe kur është e nevojshme, në lidhje me pH.

Rezultatet e marra do të paraqiten në formën e vizatimeve skematike që tregojnë rrugët e përfshira, dhe në formën e bilanceve që tregojnë shpërndarjen e etiketës radio në ujë dhe sediment, si funksion i kohës, midis:

- lëndës vepruese;
 - CO₂;
 - komponimeve të paqëndrueshme përveç CO₂;
 - produkteve individuale të identifikuara të transformimit;
 - substancave të nxjerra që nuk identifikohen; dhe
 - mbetjeve jo të ekstraktueshme në sediment.
- Kohëzgjatja e studimit duhet të jetë së paku 100 ditë.

9.2.3. Studimi i ujit/sedimentit të rrezatuar

Nëse degradimi fotokimik ka rëndësi, një studim uji/sedimenti nën ndikimin e një regjimi të zbehtë/të errët, mund të raportohet gjithashtu.

9.2.4. Vlerësimi i përqendrimeve në ujërat nëntokësore

Rrugët për ndotjen e ujit sipërfaqësor, duhet të përcaktohen duke marrë në konsideratë kushtet bujqësore, të shëndetit të bimës dhe mjedisore (duke përfshirë ato klimatike) përkatëse.

Vlerësimet e duhura (llogaritjet) për përqendrimin mjedisor të parashikuar në ujërat sipërfaqësorë PECs, të lëndës vepruese dhe metaboliteve përkatëse, produkteve të degradimit dhe të reagimit, duhet të paraqiten.

9.2.4.1. Llogaritjet e përqendrimeve në ujërat nëntokësore

Vlerësimet $PEC_{G\bar{e}}$ duhet të lidhen me numrin maksimal dhe masat më të larta të aplikimit, për të cilat regjistrimi është kërkuar, dhe të jenë të përshtatshme për liqenet, pellgjet, lumenjtë, kanalet, përrenjtë, kanalet dhe tubacionet ujitës e kullues.

Vlerësimet (llogaritjet) e përshtatshme të përqendrimit të parashikuar të mjedisit në ujërat nëntokësore $PEC_{G\bar{e}}$, të lëndës vepruese do të dorëzohen, përveç nëse është e qartë nga të dhënat për degradimin ose adsorbimin, duke marrë vlera të rastit më të keq, se rrjedhja do të ishte e papërfillshme nën zonat e synuara të përdorimit.

Për të gjithë metabolitët, produktet e degradimit ose reagimit të identifikuar si pjesë e përcaktimit të mbetjeve për vlerësimin e rrezikut në lidhje me ujërat nëntokësore (shiko kërkesat për lëndën vepruese) një llogaritje e $PEC_{G\bar{e}}$, të kërkohet për vlerësimin e rëndësisë së tyre.

9.2.5. Vlerësimi i përqendrimeve në ujërat sipërfaqësore dhe sedimentet

Rrugët e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe sedimenteve përcaktohen duke marrë parasysh kushtet përkatëse bujqësore, shëndetësore të bimëve dhe mjedisit (përfshirë ato klimatike). Vlerësimet e duhura (llogaritjet) për përqendrimin mjedisor të parashikuar në ujërat sipërfaqësorë PECSË dhe sedimentit PECSËD i lëndës vepruese do të dorëzohen, përveç nëse aplikuesi tregon se ndotja nuk do të ndodhë. Vlerësimet e PECSË dhe PECSËD do të lidhen me numrin maksimal dhe shkallët më të larta të aplikimit, në intervalin më të shkurtër, për të cilin kërkohet regjistrimi, dhe të jetë i rëndësishëm për gropa, pellgje dhe përrenj.

Llogaritjet afatshkurtra dhe afatgjata të PECSË dhe llogaritjet përkatëse afatshkurtra dhe afatgjata të PECSËD për organet përkatëse të ujit statik (pellgje; mesatare të ponderuar me kohë) dhe për masat e ujit të lëvizshëm të ngadaltë (hendeku dhe prurjet; mesataret e ponderuar me kohë), do të llogaritet me ndihmën e një dritareje kohe lëvizëse. Do të aplikohen dritare të përshtatshme kohore në lidhje me të dhënat nga studimet ekotoksikologjike.

9.3. Fati dhe sjellja në ajër.

9.3.1. Rruga dhe shkalla e degradimit në ajër dhe transportin përmes ajrit

Termi i avullueshmërisë (PEC) do të shtohet në procedurat përkatëse të vlerësimit të rrezikut për PECS dhe PECSË. Llogaritja mund të rafinohet duke përdorur të dhëna nga eksperimente të kufizuara. Kur është e nevojshme, do të sigurohen eksperimente laboratorike, tunele me erë ose fushë për të përcaktuar PECS pas masave lehtësuese të avullueshmërisë dhe depozitimit.

9.4. Vlerësimi i përqendrimeve për rrugët e tjera të ekspozimit

Vlerësimet (llogaritjet) e përshtatshme të përqendrimit të parashikuar të mjedisit, të lëndës vepruese dhe metabolitëve, produkteve të degradimit dhe reagimit do të dorëzohen, përveç nëse aplikanti tregon se ndotja nuk do të ndodhë në rast të ekspozimit nga rrugë të tjera, të tilla si:

- depozitimi i pluhurit që përmbajnë PMB-te nga depozitimi gjatë mbjelljes,
- ekspozimi indirekt i ujit sipërfaqësor përmes një impianti për trajtimin e ujërave të zeza (STP) pas aplikimit të një PMB-je në dhomat e depozitimit, dhe
- komoditeti i përdorimit.

Vlerësimet e PEC do të lidhen me numrin maksimal dhe shkallët më të larta të aplikimit, në intervalin më të shkurtër, për të cilin kërkohet regjistrimi, dhe të jenë të rëndësishme për departamentet përkatëse të mjedisit.

Lloji i informacionit që do të sigurohet do të diskutohet me autoritetin kompetent.

SEKSIONI 10

10. Të dhëna ekotoksikologjike

10.1. Efektet tek zogjtë dhe vertebrorët e tjerë tokësorë

10.1.1. Efektet tek zogjtë

Efektet e mundshme mbi zogjtë duhet të investigohen, me përjashtim të rasteve kur mund të përjashtohet mundësia e ekspozimit direkt apo indirekt e zogjve, si psh. trajtimet në mjedise të mbyllura ose trajtime për plagët.

Raporti toksicitet akut/ekspozim (TERa), raporti toksicitet ushqimor afat-shkurtër/ekspozim (TERst) dhe raporti toksicitet ushqimor afat gjatë/ekspozim (TERlt), duhet të raportohen.

ku:

TERa = LD50 (mg a.s./kg peshë trupore)/ETE (mg a.s./kg peshë trupore);

TERst = LC50 (mg a.s./kg ushqim)/ETE (mg a.s./kg ushqim);

TERlt = NOEC (mg a.s./kg ushqim)/ETE (mg a.s./kg ushqim);

ETE = vlera teorike e ekspozimit.

Në rastin e ushqimit të peletuar, granular ose farave të trajtuara, duhet gjithashtu të raportohet sasia e lëndës vepruese në secilën peletë, granulë ose farë si dhe proporcioni i LD50 për lëndën vepruese në 100 pjesë për gram. Duhet të raportohet edhe madhësia dhe forma e peletave ose granulave.

Në rastin e karremave, përqendrimi si në karrem (mg a.s./kg) raportohet.

10.1.1.1. Toksiciteti akut oral ndaj zogjve

Toksiciteti akut oral i PMB-së do të investigohet nëse toksiciteti nuk mund të parashikohet në bazë të të dhënave për lëndën vepruese, ose kur rezultatet nga testimi i gjitarëve japin dëshmi të toksicitetit më të lartë të PMB-së në krahasim me lëndën vepruese, përveç nëse aplikanti tregon se nuk ka të ngjarë që zogjtë të jenë të ekspozuar ndaj vetë PMB-së.

Kushtet e provës

Testi do të sigurojë, kur është e mundur, vlerat LD50, dozën vdekjeprurëse të pragut, kurset kohore të përgjigjes dhe rikuperimit, Nivelin e Efektit të Vëzhguar (NOEL), dhe do të përfshijë gjetjet patologjike.

Doza më e lartë e përdorur në teste nuk duhet të kalojë 2 000 mg a.s./kg peshë trupore, megjithatë, në varësi të niveleve të pritura të ekspozimit në fushë pas përdorimit të synuar të përbërësit, do të mund të kërkohen doza më të larta.

10.1.2. Efektet tek vertebrorët tokësorë përveç zogjve

Rreziqet e mundshme për speciet vertebrorë, përveç zogjve, do të investigohen, përveç kur substanca e provës përfshihet në PMB-të e përdorura, p.sh., në hapësirat e mbyllura dhe trajtimet e shërimit të plagëve, kur speciet vertebrorë të ndryshëm nga zogjtë nuk do të përjetojnë as ekspozim të drejtpërdrejtë dhe as sekondar.

10.1.2.1. Toksiciteti akut te gjitarët

Nëse ekspozimi ndaj formulimit konsiderohet i mundur dhe toksiciteti nuk mund të parashikohet në bazë të të dhënave për lëndën vepruese, do të merren parasysh të dhënat mbi toksicitetin akut oral të PMB-së nga vlerësimi toksikologjik i gjitarëve (shiko kërkesat për lëndën vepruese).

10.1.3. Efektet në jetën e egër vertebrore tokësore (zvarranikët dhe amfibët)

Kur nuk mund të parashikohet nga të dhënat e lëndëve vepruese dhe, nëse është e rëndësishme, rreziku për amfibët dhe zvarranikët nga PMB-të do të adresohet.

10.2. Efektet mbi organizmat ujorë.

Duhet të investigohen efektet e mundshme mbi speciet ujore, me përjashtim të rasteve kur mund të përjashtohet mundësia e ekspozimit të specieve ujore.

TERa dhe TERlt, duhet të raportohen,

ku:

TERa = LC50 akute (mg a.s./l)/rasti më i keq real PECs (fillestar ose afat-shkurtër, në mg a.s./l);

TERlt = NOEC kronike (mg a.s./l)/afat gjatë PECs (mg a.s./l).

Një vlerësim i rrezikut për organizmat ujorë do të bëhet në përputhje me analizën përkatëse të vlerës së rrezikut.

10.2.1. Toksiteti akut tek peshqit, jo vertebrorët ujorë, ose efektet te algat dhe makrofitet

Testimi do të kryhet kur:

toksiteti akut i PMB-se nuk mund të parashikohet në bazë të të dhënave për lëndën vepruese;

përdorimi i synuar përfshin aplikimin e drejtpërdrejtë në ujë;

ekstrapolimi në bazë të të dhënave në dispozicion për një PMB të ngjashëm nuk është i mundur.

Nëse PMB-ja përmban dy ose më shumë lëndë vepruese, dhe grupet më të ndjeshme taksonomike për lëndët vepruese individuale nuk janë të njëjta, testimi në të tre/katër grupet ujorë, domethënë peshqit, jovertebrorët ujorë, algat dhe makrofitet përkatëse, do të kërkohet.

Kushtet e provës

Zbatohen kushtet përkatëse, të parashikuara në kërkesat për lëndën vepruese.

10.2.2. Studime shtesë për toksicitetin afatgjatë dhe kronikë mbi peshqit, jovertebrorët ujorë dhe organizmat që banojnë në sedimente

Studimet e përmendura për lëndën vepruese, do të bëhen për PMB të veçantë, kur nuk është e mundur të ekstrapolohet nga të dhënat e marra në studime përkatëse mbi lëndën vepruese (psh., PMB-ja është me toksitetin akut me të lartë sesa lëndë vepruese siç prodhohet nga një faktor prej 10), përveç nëse dëshmohet se ekspozimi nuk do të ndodhë.

10.2.3. Studime shtesë për organizmat ujorë

Studimet e referuara për lëndën vepruese, mund të jenë të nevojshme për disa PMB, kur nuk është e mundur të ekstrapolohen të dhënat e fituara nga studimet korresponduese mbi lëndën vepruese ose një PMB tjetër.

10.3. Efektet mbi insektet

10.3.1. Efektet te bletët

Efektet e mundshme te bletët duhet të shqyrtohen, përveçse aty ku PMB-ja është për përdorim të veçantë, në situata ku bletët nuk janë të mundshme të ekspozohen, të tilla si:

- ruajtja e ushqimeve në hapësira të mbyllura;
- preparate jo sistemike, për aplikim në tokë;
- trajtime jo sistemike, për prodhimin e bimëve dhe transplantimin e zhardhokëve;
- mbylje e plagëve dhe trajtimet shëruese;
- karrem rodenticid jo-sistematik;
- përdorim në sera pa pllenim.

Për trajtimet e farave do të merret parasysh rreziku nga rrjedhja e pluhurit gjatë shpimit të farës së trajtuar. Nëse PMB-ja është sistemike dhe përdoret për farat, tuberët, rrënjët, të cilat aplikohen direkt në tokë, p.sh të spërkatura në tokë, kokrriza/tablete të aplikuar në tokë, ujë ujtitjeje, ose të aplikohen direkt në bimë, ose për bimë, p.sh nga spërkatja ose injeksioni, atëherë rreziku për bletët që ushqejnë ato bimë do të vlerësohen, duke përfshirë rrezikun që rrjedhin nga mbetjet e PMB-ve në nektar, polen dhe ujë, duke përfshirë edhe përmbledhjen.

Kur bletët ka të ngjarë të ekspozohen, do të bëhet testimi si nga toksiciteti akut (oral dhe kontakt) ashtu edhe nga toksiciteti kronik, përfshirë efektet nën-vdekjeprurëse.

Koeficientët e rrezikut për ekspozimin oral dhe nëpërmjet kontaktit (QHO dhe QHC), duhet të raportohen:

QHO = dozë/oral LD50 (μg lëndë vepruese/bletë);

QHC = dozë/kontakt LD50 (μg lëndë vepruese/bletë).

ku: doza = masa maksimale e aplikimit, për të cilën është kërkuar regjistrimi, në gram të lëndës vepruese/hektar.

10.3.1.1. Toksiciteti akut

Duhet të jepen të dhënat akute të toksicitetit oral dhe të kontaktit.

10.3.1.1.1. Toksiciteti akut oral

Duhet të jepen të dhënat akute të toksicitetit oral, i cili përcakton vlerat akute LD50 së bashku me NOEC. Efektet nën-vdekjeprurëse, nëse vërehen, do të raportohen.

Rezultatet do të paraqiten në μg produkt/bletë.

10.3.1.1.2. Toksiciteti akut nëpërmjet kontaktit

Duhet të jepen të dhënat akute të toksicitetit të kontaktit akut që përcakton vlerat akute LD50 së bashku me NOEC. Efektet nën-vdekjeprurëse, nëse vërehen, do të raportohen.

Rezultatet do të paraqiten në μg produkt/bletë.

10.3.1.2. Toksiciteti kronik

Duhet të jepen të dhënat etoksicitetit kronik të bletët që përcakton kronikun oral EC10, EC20, EC50 së bashku me NOEC. Kur nuk mund të vlerësohet kroniku oral EC10, EC20, EC50, duhet të jepet një shpjegim. Efektet nën-vdekjeprurëse, nëse vërehen, do të raportohen.

Testi do të bëhet kur bletët ka të ngjarë të ekspozohen.

Rezultatet do të paraqiten në μg produkt/bletë.

10.3.1.3. Efektet të bletët në zhvillim dhe në fazat e tjera të jetës

Të dhënat e larvave duhet të sigurojnë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar rreziqet e mundshme nga PMB-ja në larvat e bletëve.

10.3.1.4. Efektet nën-vdekjeprurëse

Mund të kërkojnë teste që hetojnë efektet nën-vdekjeprurëse, siç janë efektet e sjelljes dhe riprodhimit, të bletët dhe, kur është e aplikueshme, në koloni.

10.3.1.5. Testet e kafazit dhe tunelit

Duhet të jepet informacion i mjaftueshëm për të vlerësuar:

a) rreziqet e mundshme nga PMB-ja për mbijetesën dhe sjelljen e bletëve, dhe

b) ndikimi të bletët që vijnë nga ushqimi me vesë ose lule të ndotura të mjaltit.

Efektet nën-vdekjeprurëse adresohen, nëse është e nevojshme, duke kryer teste specifike (psh. sjellja foragjere).

Kur efektet akute ose kronike në mbijetesën dhe zhvillimin e kolonisë nuk mund të përjashtohen, testimi i mëtutjeshëm do të kërkojë veçanërisht nëse efektet vërehen në testin e ushqyerjes së gjirit të bletëve (shiko kërkesat për lëndën vepruese) ose nëse ka indikacione për efekte indirekte siç janë veprimi i vonuar, efektet në fazat e të miturve ose modifikimi i sjelljes së bletëve; ose efekte të tjera të tilla si efektet e zgjatura të mbetjeve; në ato raste testet e kafazit/tunelit duhet të bëhen dhe raportohen.

Kushtet e provës

Testi do të bëhet duke përdorur koloni të shëndetshme të mbretëreshës së kosheres, në të cilat patogjenët janë të ulët dhe monitorohen rregullisht.

10.3.1.6. Testet në terren me bletët e mjaltit

Duhet të jepen të dhënat që të sigurojnë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar rreziqet e mundshme nga PMB-ja në sjelljen e bletëve, mbijetesën e kolonisë dhe zhvillimin.

Efektet nën-vdekjeprurëse do të adresohen, nëse është e nevojshme.

10.3.2. Efektet në artropodët jo të synuar përveç bletëve

Efektet në artropodet tokësore jo të synuar do të investigohen për të gjithë PMB-të, përveç rasteve kur PMB-të që përmbajnë lëndën vepruese janë për përdorim ekskluziv në situata kur artropodët jo të synuar nuk janë të ekspozuar siç janë:

- a) ruajtja e ushqimit në hapësirat e mbyllura që parandalojnë ekspozimin;
- b) trajtimet e mbylljes dhe shërimit të plagëve;
- c) hapësirat e mbyllura me rodenticid karrem.

Duhet të jepen të dhënat nëse:

- a) PMB-ja përmban më shumë se një lëndë vepruese,
- b) toksiteti i një PMB-je nuk mund të parashikohet me besueshmëri të jetë i njëjtë ose më i ulët se lënda vepruese e testuar, në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Për PMB-të, duhen testuar dy specie treguese, *Aphidius rhopalosiphii* (Hymenoptera: Braconidae) dhe merimangat grabitqare *Typhlodromus pyri* (Acari: Phytoseiidae). Testimi fillestar duhet të bëhet duke përdorur pllaka qelqi, dhe vdekshmëria dhe efektet në riprodhim (nëse vlerësohen) raportohen. Testimi do të përcaktojë një marrëdhënie normë-përgjigje dhe pikat e fundit të LR50, ER50 dhe NOEC raportohen për vlerësimin e rrezikut për këto specie në përputhje me analizën përkatëse të vlerësuesit të rrezikut.

Për një PMB që përmban një lëndë vepruese që dyshohet të ketë një mënyrë të veçantë veprimi (për shembull rregullatorët e rritjes së insekteve, frenuesit e ushqyerjes së insekteve) mund të kërkohen teste shtesë që përfshijnë faza të ndjeshme të jetës, rrugë të veçanta tërheqjeje ose modifikime të tjera. Arsyetimi për zgjedhjen e specieve të përdorura të provës duhet të sigurohet.

Testimi duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar toksicitetin (vdekshmërinë) e PMB-së ndaj artropodëve në terren, si dhe në zonën jashtë fushës.

10.3.2.3. Studime gjysmë fushore me artropodë jo të synuar

Testet duhet të japin informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e PMB-së për artropodët që marrin parasysh kushtet në terren.

Rrethanat në të cilat kërkohet

Kur efektet shihen pas testimit laboratorik në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese ose pikës 10.3.2, të këtij seksioni (p.sh. vlerat përkatëse të provëzave janë shkelur), kërkohet testimi gjysmë fushor.

Kushtet e provës

Testet do të bëhen nën kushte përfaqësuese bujqësore dhe në përputhje me rekomandimet e propozuara për përdorim, duke rezultuar në një studim realist më të keq.

Në testimin gjysmë fushor, rezultatet nga testimi i nivelit të ulët, si dhe pyetjet specifike për t'u adresuar do të merren parasysh. Në përzgjedhjen e llojeve për testimin gjysmë fushor, rezultatet e testimit të nivelit të ulët, si dhe pyetjet specifike për t'u adresuar do të merren parasysh.

Testimi do të përfshijë pikat fundore vdekjeprurëse dhe nën-vdekjeprurëse (p.sh. parametrat e integruar në studimet në terren), por pikat e tilla përfundimtare interpretohen me kujdes pasi ato i nënshtrohen ndryshueshmërisë së lartë.

10.3.2.4. Studime në terren me artropodë jo të synuar

Duhet të jepet informacion i mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e PMB-së për artropodët që marrin parasysh kushtet në terren.

10.4. Efektet në meso dhe makrofauna jo-tokësore

10.4.1. Krimbat e tokës

Ndikimi i mundshëm në krimbat e tokës raportohet përveç nëse aplikanti tregon se nuk ka të ngjarë që krimbat e tokës të ekspozohen, direkt ose indirekt.

Një vlerësim i rrezikut për krimbat e tokës do të bëhet në përputhje me analizën përkatëse të vlerës së rrezikut.

10.4.1.1. Krimbat e tokës, efektet nën-vdekjeprurëse

Duhet të jepen të dhënat mbi efektet në rritjen dhe riprodhimin e krimbit të tokës.

10.4.1.2. Krimbat e tokës, studimet në terren

Duhet të jepen të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar efektet në krimbat e tokës në kushte fushore.

10.4.2. Efektet në meso- dhe makrofaunen jo-tokësore të tokës (përveç krimbave të tokës)

Efektet në organizmat e tokës (përveç krimbave të tokës) do të investigohen për të gjithë PMB-te, përveç në situatat kur organizmat e tokës nuk janë të ekspozuar siç janë:

- a) ruajtja e ushqimit në hapësirat e mbyllura që parandalojnë ekspozimin;
- b) trajtimet e mbylljes dhe shërimit të plagëve;
- c) hapësirat e mbyllura me rodenticid karrem.

Duhet të jepen të dhënat nëse:

- a) PMB-ja përmban më shumë se një lëndë vepruese,
- b) toksiciteti i një PMB-je nuk mund të parashikohet në mënyrë të besueshme të jetë i njëjtë ose më i ulët se lënda vepruese e testuar në përputhje me kërkesat për lëndën vepruese.

Për PMB-të e përdorura për trajtim gjethesh, të dhënat për dy speciet përkatëse të artropodit mund të merren parasysh për një vlerësim paraprak të rrezikut. Nëse efektet ndodhin në secilën specie, do të kërkohet testim në *Folsomia candida* dhe *Hypoaspis aculeifer* (shiko pikën 10.4.2.1).

Nëse të dhënat për *Aphidius rhopalosiphii* dhe *Typhlodromus pyri* nuk janë të disponueshme, atëherë do të kërkohen të dhënat e përshkruara në pikën 10.4.2.1.

Për PMB-të e përdorura drejtpërdrejt në tokë, si lëng ose si një formulim i ngurtë, atëherë do të kërkohet testim si në *Folsomia candida* ashtu dhe *Hypoaspis aculeifer* (shih pikën 10.4.2.1).

10.5. Efektet në transformimin e azotit në tokë

Duhet të jepen të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar ndikimin e PMB-ve në aktivitetin mikrobial të tokës në drejtim të transformimit të azotit.

10.6. Efektet në bimë më të larta tokësore jo-synuese

Efektet e PMB-ve në bimë jo-objekt raportohen, nëse toksiciteti i PMB-së nuk mund të parashikohet në bazë të të dhënave për lëndën vepruese, përveç nëse kërkuesi tregon se nuk ndodh ekspozim.

10.6.1. Testim në bimë jo të synuara

Duhet të jepen të dhënat për vlerat ER50 të PMB-së për bimët jo të synuara.

10.7. Efektet në organizmat e tjerë tokësorë (flora dhe fauna)

Çdo e dhënë në dispozicion për efektet e PMB-së në organizmat e tjerë tokësorë do të dorëzohet.

10.8. Monitorimi i të dhënave

Të dhënat e disponueshme të monitorimit në lidhje me efektet e PMB-së tek organizmat jo-target do të raportohen.

SEKSIONI 11

11. Klasifikimi dhe etiketimi

11.1. Propozimet për klasifikimin dhe etiketimin e PMB-së në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve, kur është e aplikueshme, do të dorëzohen dhe arsyetohen, përfshirë:

- a) piktogramet,
 - b) fjalët sinjalizuese,
 - c) deklaratat e rrezikut, dhe
 - d) deklaratat paraprahe.
- 11.2. Etiketa e propozuar.

PJESA B

PMB ME PËRMBAJTJE LËNDË VEPRUESE ME NATYRË BIOLOGJIKE

SEKSIONI 1

1. Identiteti i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Informacioni i dhënë, i marrë së bashku me ato të parashikuara për mikroorganizmat, duhet të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar dhe përcaktuar saktësisht përgatitjet. Informacioni dhe të dhënat e referuara, përveç nëse specifikohet ndryshe, kërkohet për të gjithë PMB-të. Ky është me synimin për të identifikuar nëse ndonjë faktor mund të ndryshojë vetitë e mikroorganizmit si një produkt për mbrojtjen e bimëve në krahasim me mikroorganizmin si i tillë.

1.2 Aplikuesi

Emri dhe adresa e aplikuesit duhet të deklarohet së bashku me emrin, pozicionin, numrin e telefonit dhe të faksit, të personit të kontaktit.

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

1.2. Prodhuesi i PMB-së dhe i dhe mikroorganizmit/ve

Prodhuesi i PMB-së:

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

Informacion konfidencial - të dhëna të siguruara veçmas.

Prodhuesi i mikroorganizmi/ve

Emri:

Adresa:

Kontakti:

Numër telefoni:

Fax:

E-mail:

Vendndodhja e vendit të prodhimit:

Informacion konfidencial - të dhëna të siguruara veçmas.

1.3. Emri tregtar ose propozimi për emrin tregtar, si dhe numri i kodit i vendosur nga prodhuesi për PMB-në, kur është e nevojshme

Duhet të deklarohen të gjithë emrat tregtarë të mëparshëm dhe të tanishëm, si dhe emrat tregtarë të propozuar dhe kodet e PMB-ve të dhëna nga prodhuesi. Detajet e plota të ndryshimeve duhet të jepen (Emri tregtar i propozuar nuk duhet të jetë shkak për konfuzion me emrin tregtar të një PMB-je të regjistruar).

1.4. Informacion i detajuar sasior dhe cilësor mbi përbërjen e PMB-së (Informacion konfidencial)

- Çdo mikroorganizëm që i nënshtrohet aplikimit do të identifikohet dhe emërohet në nivelin e specieve. Mikroorganizmi depozitohet në një koleksion të njohur të kulturës dhe i jepet një numër hyrje. Duhet të theksohet emri shkencor, si dhe caktimi i grupit (baktere, viruse, etj.) dhe çdo emërtim tjetër i rëndësishëm për mikroorganizmin (p.sh. raca, stereotipi). Për më tepër, duhet të përcaktohet faza e zhvillimit të mikroorganizmit (p.sh. spore, micel) në produktin e caktuar për treg.

- Për PMB-të duhet të jepet informacioni i mëposhtëm:

- përmbajtja e mikroorganizmit/ve në PMB dhe përmbajtja e mikroorganizmit në materialin e përdorur për prodhimin e PMB-ve. Këto duhet të përfshijnë përmbajtjen maksimale, minimale dhe nominale të materialit të zbatueshëm dhe jo të zbatueshëm;

- përmbajtja e bashkë-formuluesëve;

- përmbajtja e komponentëve të tjerë (të tilla si nën-produkti, kondensuesit, kultura mesatare, etj.) dhe mikroorganizmave kontaminues, që rrjedhin nga procesi i prodhimit.

Përmbajtja do të shprehet me termat siç parashikohet në legjislacionin për kimikatet dhe në terma të duhur për mikroorganizmat (numri i njërive aktive për vëllim ose peshë ose çfarëdo mënyre tjetër që ka lidhje me mikroorganizmin).

- Bashkë-formuluesit duhet, kur është e mundur, të identifikohen ose nga Identifikimi Ndërkombëtar Kimik i tyre, siç është në legjislacioni e klasifikimit të kimikateve, ose, nëse nuk përfshihet në këtë legjislacion, në përputhje me të dy nomenklaturat IUPAC dhe CA. Struktura ose formula e tyre strukturore duhet të jepet. Për secilën përbërës të bashkë-formuluesve duhet të sigurohet numri EC përkatës (EINECS ose ELINCS) dhe numri CAS aty ku ato ekzistojnë. Kur informacioni i dhënë nuk e identifikon plotësisht një bashkë-formulues, duhet të sigurohet një specifikim i duhur. Emri tregtar i bashkë-formuluesve, aty ku ato ekzistojnë, gjithashtu duhet të jepet.

- Për bashkë-formuluesit duhet të jepet funksioni i tyre:

- adeziv;

- lëndë anti shkumëzuese;

- anti ngrirës;

- lidhës;

- zbutës;

- mbartës;

- deodorant;

- lëndë shpërndarëse;

- ngjyruar;

- emetues;

- përzierës;

- fertilizant;

- ruajtës;

- aromatizues;

- parfum;

- lëvizës;

- zbrapsës;

- element sigurie;
- tretës;
- stabilizues;
- sinergjist;
- trashës;
- lëndë njomëse;
- të ndryshme (të specifikohet).

- Identifikimi i mikroorganizmave kontaminues dhe përbërësve të tjerë që rrjedhin nga procesi i prodhimit.

Mikroorganizmat kontaminues duhet të identifikohen.

Kimikatet (përbërësit inertë, nënproduktet, etj.) duhet të identifikohen.

Kur informacioni i dhënë nuk e identifikon plotësisht një komponent, siç është kondensuesi, kultura mesatare, etj., informacionet e hollësishme mbi përbërjen duhet të sigurohen për secilin përbërës të tillë.

1.5. Gjendja fizike dhe natyra e PMB-së

Tipi dhe kodi i PMB-së duhet të përcaktohen sipas “Katalogut për tipin e formulave të pesticideve dhe sistemit ndërkombëtar të kodeve (GIFAP Technical Monograph No 2. 1989)”.

Kur në këtë publikim nuk është përcaktuar me saktësi një PMB e veçantë, duhet të jepet një përshkrim i plotë i natyrës fizike dhe strukturës së PMB-së, së bashku me propozimin për përshkrimin e përshtatshëm dhe propozimin për emërtimin e tij.

1.6. Funksioni.

Funksioni biologjik duhet të specifikohet si më poshtë:

- kontrolli i baktereve,
- kontrolli i kërpudhave,
- kontrolli i insekteve,
- kontrolli i merimangave,
- kontrolli i molusqeve,
- kontrolli i nematodave,
- kontrolli i barërave të këqija,
- të tjera (duhet të specifikohen).

SEKSIONI 2

2. Veçoritë fizike, kimike dhe teknike të produktit për mbrojtjen e bimëve (Plotëso tabelën përmbledhëse në vijim)

2.1. Veçoritë e jashtme (ngjyra dhe era)

Të jepet përshkrimi i ngjyrës dhe erës, kur ka të tilla, si dhe i strukturës fizike të PMB-së.

2.2. Stabiliteti i ruajtjes dhe jetëgjatësia e ruajtjes

2.2.1. Efektet e dritës, temperaturës dhe lagështisë në karakteristikat teknike të PMB-së

Stabiliteti fizik dhe biologjik i PMB-së në temperaturën e rekomanduar të ruajtjes, përfshirë informacionin mbi rritjen e mikroorganizmave kontaminues, duhet të përcaktohet dhe raportohet. Kushtet në të cilat është kryer testi duhet të jenë të justifikuara;

Për më tepër, në rastin e PMB-ve të lëngshme, efekti i temperaturave të ulëta në stabilitetin fizik, duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodat CIPAC MT 39, MT 48, MT 51 ose MT 54, siç është e përshtatshme;

Kohëzgjatja e PMB-së në temperaturën e rekomanduar të ruajtjes duhet të raportohet. Kur jetëgjatësia është më pak se dy vjet, jetëgjatësia në muaj, me specifikimet e duhura të temperaturës, duhet të raportohet. Informacione të dobishme jepen në Monografinë GIFAP Nr 17.

2.2.2. Faktorë të tjerë që ndikojnë në stabilitetin

Efekti i ekspozimit ndaj ajrit, paketimit, etj., në stabilitetin e PMB-së duhet të jepet.

2.3. Eksploziviteti dhe vetitë oksiduese

Eksplziviteti dhe vetitë oksiduese do të jepen siç përcaktohet në pikën 2.2 të pjesës A, përveç nëse mund të justifikohet që teknikisht ose shkencërisht nuk është e nevojshme të kryhen studime të tilla.

2.4. Pika e ndezjes dhe tregues të tjerë të ndezshmërisë ose ndezjes spontane

Pika e ndezjes dhe ndezshmëria duhet të përcaktohen, siç përcaktohet në pikën 2.3 të pjesës A, përveç nëse mund të justifikohet që teknikisht ose shkencërisht nuk është e nevojshme të kryhen studime të tilla.

2.5. Aciditeti/alkaliteti dhe vlera e pH

Aciditeti, alkaliteti dhe pH do të jepen siç përcaktohet në pikën 2.4 të pjesës A, përveç nëse mund të justifikohet që teknikisht ose shkencërisht nuk është e nevojshme për të kryer studime të tilla.

2.6. Viskoiziteti dhe tensioni sipërfaqësor

Viskoiziteti dhe tensioni sipërfaqësor do të jepen siç përcaktohet në pikën 2.5 të pjesës A, përveç nëse mund të justifikohet që teknikisht ose shkencërisht nuk është e nevojshme për të kryer studime të tilla.

2.7. Karakteristikat teknike të produktit për mbrojtjen e bimëve

Karakteristikat teknike të PMB-së duhet të përcaktohen për të lejuar marrjen e një vendimi në lidhje me pranueshmërinë e tij. Nëse duhet të kryhen teste, ato duhet të bëhen në temperatura të përputhshme me mbijetesën e mikroorganizmit.

2.7.1. Lagështia

Lagështia e PMB-ve të ngurta, të cilat hollohen për përdorim (p.sh. pluhurat e lagësht dhe granulat shpërndarëse në ujë), duhet të përcaktohen dhe raportohen në përputhje me metodën CIPAC MT 53.3.

2.7.2. Shkumëzimi i vazhdueshëm

Qëndrueshmëria e shkumëzimit të PMB-së, që do të tretet me ujë, duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 47.

2.7.3. Pezullueshmëria dhe qëndrueshmëria e pezullimit

Pezullueshmëria e PMB-ve të shpërndara në ujë (p.sh. pluhurat e lagësht, granulat shpërndarëse në ujë, koncentratet e pezullimit) duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 15, MT 161 ose MT 168, siç është e përshtatshme.

Spontaniteti i shpërndarjes së PMB-ve të shpërndara në ujë (p.sh. koncentratet e pezullimit dhe granulat shpërndarëse në ujë) duhet të përcaktohen dhe raportohen në përputhje me Metodën CIPAC MT 160 ose MT 174, siç është e përshtatshme.

2.7.4. Testi i sitës së thatë dhe i sitës së lagësht

Për të siguruar që pluhurat të kenë një shpërndarje të përshtatshme të madhësisë së grimcave për lehtësinë e aplikimit, duhet të bëhet një provë e sitës së thatë dhe të raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 59.1.

Në rastin e PMB-ve të shpërndara në ujë, duhet të bëhet një test i sitës së lagësht dhe të raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 59.3 ose MT 167, siç është e përshtatshme.

2.7.5. Shpërndarja e madhësisë së grimcave (pluhurat për pluhurosje dhe të lagësht, granulat), përmbajtja e pluhurit/kokrrizave, tretjes dhe shkrifjes (granulat)

- Shpërndarja e madhësisë së grimcave në rastin e pluhurave duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën 110 të OECD.

Gama e madhësive nominale të granulave për aplikim të drejtpërdrejtë duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me CIPAC MT 58.3, për granulën shpërndarëse në ujë raportohet në përputhje me CIPAC MT 170.

- Përmbajtja e pluhurit të PMB-ve granulare, duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 171. Nëse është e rëndësishme për ekspozimin e operatorit, madhësia e grimcave të pluhurit duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën 110 të OECD;

- Karakteristikat e shkrifshmërisë dhe tretjes së granulave duhet të përcaktohen dhe raportohen pasi të jenë të disponueshme metodat e dakorduara ndërkombëtare. Kur tashmë janë të disponueshme të dhënat, ato duhet të raportohen së bashku me metodën e përdorur.

2.7.6. Emulsifikueshmëria, ri-emulsifikueshmëria, qëndrueshmëria e emulsionit

Emulsifikueshmëria, qëndrueshmëria e emulsionit dhe ri-emulsifikueshmëria e PMB-ve, të cilat ekzistojnë si emulsione në rezervuarin e spërkatjes, do të përcaktohen dhe raportohen në përputhje me metodën CIPAC MT 36 ose MT 173, sipas rastit.

Stabiliteti i emulsioneve të holluara dhe PMB-ve që janë emulsione, duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 20 ose MT 173.

2.7.7. Rrjedhshmëria, shpëlarja dhe trazimi (Pluhurueshmëria)

Karakteristikat e mëposhtme përcaktohen dhe raportohen:

Shkalla e rrjedhshmërisë së PMB-ve të granuluar duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 172;

Shpëlarja (përfshirë edhe mbetjet e shpëlarjes) e suspensioneve (p.sh. suspension i koncentruar, suspo-emulsionet) duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 148;

Pluhurueshmëria e pluhurave të pudrosur pas ruajtjes së përsheptuar duhet të përcaktohet dhe raportohet në përputhje me metodën CIPAC MT 34 ose një metodë tjetër të përshtatshme.

2.8. Përputhshmëria fizike, kimike dhe biologjike me produkte të tjera përfshirë dhe PMB-të, me të cilat do të autorizohet përdorimi

2.8.1. Përputhshmëria fizike

Përputhshmëria fizike në rezervuare (tankera) e PMB-ve të rekomanduara duhet të përcaktohet dhe raportohet.

2.8.2. Përputhshmëria kimike

Përputhshmëria kimike në rezervuare (tankera) e PMB-ve të rekomanduara duhet të përcaktohet dhe raportohet, përveç rasteve kur ekzaminimi i vetive individuale të PMB-ve do të krijonte përtej dyshimit të arsyeshëm se nuk ka mundësi të reagimit. Në raste të tilla është e mjaftueshme të sigurohen këto informacione si justifikim për të mos përcaktuar praktikisht përputhshmërinë kimike.

2.8.3. Përputhshmëria biologjike

Përputhshmëria biologjike e përzierjes të rezervuarit duhet të përcaktohet dhe raportohet. Efektet (p.sh. antagonizmi, efektet kërpudhore) në aktivitetin e mikroorganizmit pas përzierjes me mikroorganizma ose kimikate të tjerë duhet të përshkruhen. Ndërveprimi i mundshëm i PMB-së me produkte të tjerë kimikë që do të aplikohen në kulturat në kushtet e pritshme të përdorimit të PMB-së do të investigohet, bazuar në të dhënat e efikasitetit. Intervali midis aplikimit të PMB-ve biologjike dhe atyre kimike përcaktohet, nëse është e përshtatshme, në mënyrë që të shmanget humbja e efikasitetit.

2.8.4. Shkalla e tretjes dhe stabilitetit të tretësirës

Shkalla e shpërbërjes dhe qëndrueshmëria e tretësirës të produkteve të tretshme në ujë përcaktohen dhe raportohen.

2.8.5. Shpërndarja e madhësisë së grimcave, përmbajtja e pluhurit, tretja dhe qëndrueshmëria mekanike

2.8.5.1. Shpërndarja e madhësisë së grimcave

Në rastin e PMB-ve të shpërndara në ujë, duhet të bëhet dhe të raportohet një test i sitës se lagësht.

Shpërndarja e madhësisë së grimcave në rastin e pluhurave dhe përqendrimeve të pezullimit përcaktohet dhe raportohet.

Gama e madhësive nominale të kokrrizave përcaktohet dhe raportohet.

2.8.5.2. Përmbajtja e pluhurit

Përmbajtja e pluhurit të PMB-ve kokrrizore përcaktohet dhe raportohet.

Nëse rezultatet tregojnë $> 1\%$ ë/ë pluhur, atëherë madhësia e grimcave të pluhurit të gjeneruar do të përcaktohet dhe raportohet.

2.8.5.3. Tretja

Karakteristikat e tretjes së kokrrizave dhe tabletave të paketuara do të përcaktohen dhe raportohen.

2.8.5.4. Fortësia dhe integriteti

Fortësia dhe integriteti i tabletave përcaktohen dhe raportohen.

2.8.6. Emulsifikabiliteti, ri-emulsifikueshmëria, stabiliteti i emulsionit

Emulsifikueshmëria, stabiliteti i emulsionit dhe ri-emulsifikueshmëria e PMB-ve, të cilat ekzistojnë si emulsione në rezervuarin e tretësirës, do të përcaktohen dhe raportohen.

2.10. Adeherenca dhe shpërndarja tek farat

Në rastin e PMB-ve, që do të përdoren për trajtimin e farave, duhet të përcaktohet dhe të raportohet adezioni dhe shpërndarja e PMB-së.

2.11. Përmbledhja dhe vlerësimi i të dhënave të paraqitura sipas pikave 2.1. deri 2.10

Studimet plotësuese të nevojshme për klasifikimin e PMB-ve, sipas rrezikut do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI 3

3. Të dhëna mbi aplikimin (përdorimin)

Të dhënat për aplikimin duhet të parashtrihen (paraqiten) dhe duhet të jenë në përputhje me praktikat e mira të mbrojtjes së bimëve.

3.1. Fushat e përdorimit

Fushat e përdorimit, ekzistuese dhe të propozuara, duhet të specifikohen si vijon:

a) përdorim në tokë, si bujqësi, hortikulturë, pyje dhe vreshtari, kultura të mbrojtura, kontrolli i barërave të këqija në zona të pa kultivuara;

b) kopshtari;

c) bimë dhe lule shtëpie;

ç) praktika të ruajtjes së produkteve bimore;

d) të tjera (të specifikohet).

3.2. Efektet te organizmat e dëmshëm

Duhet të tregohet natyra e efekteve mbi organizmat e dëmshëm:

a) veprim nëpërmjet kontaktit;

b) veprim nëpërmjet stomakut;

c) veprim nëpërmjet thithjes me frymëmarrje;

ç) veprim fungitoksik;

d) veprim fungostatik;

dh) desikant;

e) inhibitor riprodhimi;

ë) të tjera (të specifikohet).

Për më tepër, do të specifikohet nëse PMB-ja është sistemike apo jo në bimë.

3.3. Detaje të qëllimit të përdorimit

Detajet e përdorimit të synuar do të ofrohen, përfshirë, informacionin e mëposhtëm:

